

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7779 E enjte 31 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** *i* **Ditës**

**A**dministrata e Donald Trump, në këtë rast arkitekti i presioneve ndaj qeverisë së Kosovës e kundërshtar i pavarësisë së Kosovës (Këshilltari ...)

Vijon në faqen 20

Nga EDMOND KRASNIQI

Nxiti enigmatik i kabinetit të Trump për paktin 'Thaçi-Vuçiç'



**Opinion** *i* **Ditës**

**M**e vonesë disaditore e vërejtja dhe lexova letrën e shkruar prej filozofit, shkrimtarit e publicistit, Bernar-Henri Levy, e të nënshkruar prej njëzet ...

Vijon në faqen 21

Nga REXHEP QOSJA

Reagim ndaj letrës së 30 shkrimtarëve dhe publicistëve



## PERGJIMET/ SI I BLEU VOTAT BANDA E SHIJAKUT. ALTIN AVDYLI: PO HAME DREKE ME VANGJUSHIN LIDHJA E 'GJUSHIT' ME AVDYLET "Ça halli t'ketë Niçja, mbaroi punë"

- "Zëri i Amerikës" publikon bisedat e të arrestuarve për drogë, që implikojnë kryebashkiakun e Durrësit
- Investigimi/ Vangjush Dako ua shpërbleu Avdyllëve duke i dhënë akses në institucionet kryesore lokale

Nga KLODIANA LALA

**N**ë katin e tretë të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, zyrtarë e prokurorëve që drejtojnë hetimet e dosjeve 339 dhe 339/1 janë të mbushura dëng me dokumente. Fletët e fashikujve gjenden të shpërndara mbi tavolina dhe dësheme, ndër kohë ...

Vijon në faqet 2-3



(Në foto:) Kryetari i Bashkisë Durrës, Vangjush Dako. Vëllezërit, Altin dhe Astrit Avdyli. Faksimile e përgjimeve



Tel chiamato = 698967765  
Tel Chiamato = 35569388025  
Imei = 359769069743761

0698967765: Si jeni, a jeni mirete gjithë  
0693888025: Kam leviz një eku kshu...  
0698967765: Ke levizë anej, nuk je knej ?  
0693888025: Jo perzoten nuk jam  
0698967765: Ne ate shokun jeni tu hanger buk, me Gjushin, te Hanen e paem lane te vishë me taku, megjithate po e takoi me baba lane, me tsakun.  
0693888025: Shife vete o burre se nuk ka problem, se vi une nuk ka problem  
0698967765: Jemi me Astritin eme ni fjale ktu edhe te Hanen e kemi lane  
0693888025: Po mire  
0698967765: Jemi te Majestiku ne Gjushin tu hanger një dreke  
0693888025: Po mire shife vete, sikur te bash une ty, ta bajm një ga o burre  
0698967765: Mire vlla te rucet zoti se te jap une pergjigje ne telefon...  
0693888025: Falemerrit

**"KA DEPRESSION", SI U LIRUA PARA KOHE I DENUARI PER VRASJE, ASTRIT AVDYLI**



Në faqen 3

### KOMPENSIMI

**Drejtoresha e ATP: Si do të ndahen 50 miliardë lekë, formulari i aplikimit**

Në faqen 10

### PROBLEMET

**"Luarasi", tryezë për mbrojtjen e konsumatorit, Ruka: Çështje sensitive**

Në faqen 13

### GRUPI KRIMINAL

**Itali, kapen 7 tonë kokainë. Kush është shqiptari i arrestuar në Tiranë për trafik**

Në faqen 9

### QEVERIA

**Publikohet CV-ja e Gent Cakajt, Rama emëron një tjetër zv.ministër të Jashtëm**

Në faqen 5

Historia/ Si u shuajtën 3 djemtë e familjes Bilali, vëllai ish-mundës i Dinamos

## Vritet ish-oficeri i policisë, dyshimi: Hakmarrje

Ekzekutohet para shtëpisë Arben Bilali, në 2010 e plagosën në lokal

**H**akmarrja godet sërisht familjen Bilali në Tiranë. Ish-efektivi i policisë, Arben Bilali, i cili i mbijetoi një atentati në vitin 2010, u ekzekutua pasditën e djeshme me breshëri automatiku në zonën e Selitës në kryeqytet, pak metra larg banesës së tij, 50-vjeçari, i cili pohohet se

ruhej prej kohësh u qëllua me 10 plumba nga persona ende të paidentifikuar, teksa po udhëtonte me automjetin tip "Hunday" e me targa AA867HX. Për pasojë ai ka mbetur i plagosur rëndë. Ndonëse është dërguar menjëherë në Spitalin e Traumës, ish-punonjësi i policisë nuk



u ka mbijetuar plagëve të marra në kokë dhe në trup. Mësohet se Bilali u vra afër vendit ku 9 vite më parë u ekzekutua vëllai i tij, Leonard Bilali, ish-mundës i Dinamos. Krismat e armëve kanë shkaktuar panik, ndërka policia ka ...

Në faqen 8

# MANIPULIMI I ZGJEDHJEVE BANDA E SHIJAKUT

Investigimi i "Zërit të Amerikës" dhe BIRN për lidhjet e politikës me krimin e organizuar

## "Po hajmë një drekë me Gjushin", ja si Avdylët blenë vota për kryebashkiakun

Dhjetëra përgjimet vërtetojnë manipulimet në zgjedhjet 2017

Klodiana Lala

Në katin e tretë të Prokurorisë së Kri meve të Rënda, zyrat e prokurorëve që drejtojnë hetimet e dosjeve 339 dhe 339/1 janë të mbushura dëng me dokumente. Fletët e fashikujve gjenden të shpërndara mbi tavolina dhe dyshe, ndërkohe që një seri kutish kartoni të mbushura me CD presin radhën për t'u zbardhur.

Mbi njërin prej kutive dalon shënimi me shkrim dore "korrupsion dhe blerje votash; 42 CD".


Një kat më poshtë, katër oficerë të policisë gjyqësore transkriptojnë përgjime që datojnë nga viti 2016. Nuk ka ende një bilanc të qartë, por mbeten ende dhjetra CD me përgjime të patranskriptuara.

Dosja hetimore 339 zuri fill në vitin 2016 me përgjimin e anëtarëve të një organizate të kimit të organizuar me bazë në Shijak dhe me fije të shpërndara në të dy skajet e Shqipërisë, të përfshirë në trafikun e heroinës dhe të kokainës. Bisedat telefonike me grupin "Avdyl" e zgjeruan rrethin e hetimeve edhe të një numër zyrtarësh dhe dy ish-deputetë të Partisë Socialiste, të cilët akuzohen për korrupsion dhe falsifikime me tokat.

E ndarë më vete në vitin 2017, nga dosja 339/1 është zbuluar vetëm "maja e ajsbergut".

Por të dhënat e siguruar nga BIRN hedhin dritë mbi episode të dyshuara të përfshirjes së kimit të organizuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 në Durrës, Kavajë dhe Lezhë, ndërkohe që Shqipëria po shkon drejt një procesi të ri elektoral pa kryer ende një reformë të thellë zgjedhore.

Dokumente hetimore dhe përgjime të siguruar nga BIRN ngrejnë dyshime se anëtarët e grupit Avdyl u përfshinë në blerje votash në ndihmë të kryetarit të bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako gjatë zgjedhjeve parlamentare të 25 qershorit



### "DUA LEKET MBRAPSHT"

"Është filmue ajo punë, le tashi. Të më japë lekët mbrapsht Miri, ka mbaruar ai muhabet," thotë njëri prej biseduesve. "Ne i japim lekët me mbaru ato punë e halle që keni, jo me dhanë lekë e mos me dhanë votën," shtohet në përgjim.

2017.

Bisedat telefonike tregojnë gjithashtu një marrëdhënie të shtrirë në kohë mes Dakos dhe vëllezërve Avdyl, kontributi i të cilëve në zgjedhje duket se është shpërblyer me akses pranë disa institucioneve kyçe në Durrës.


Përfshirja e grupit "Avdyl" në shit-bleje votash nuk është një rast i izoluar. Një hetim i dytë i Prokurorisë së Krimeve të Rënda, inisur pas kallëzimit të Partisë Demokratike për manipulimin e zgjedhjeve të 11 shtatorit 2016 në Dibër ekspozon gjithashtu persona me precedentë si dhe aparatit shtetëror lokal në orientimin apo manipulimin e votës.

Rekrutimi i personazheve të kimit të organizuar për mbushjen e hambarit të votave fajësohet si një ndër arsyt kryesore për rrënimin e besimit për zgjedhje të lira në Shqipëri.

Opozita akuzon kryeministrin Rama se e ka kthyer bashkëpunimin me krimin në një strategji për mbajtjen e pushtetit, ndërkohe që Partia Socialiste dhe kryeministri i kanë mohuar akuzat dhe i cilësojnë ato alibi për humbjen e zgjedhjeve.

Megjithatë, ekspertët të zgjedhjeve u bien këmbanave të alarmit me roli i grupeve kriminale në disa zona periferike është tanimë edhe më i madh se ai i partive politike.

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka konfirmuar vazhdimin e hetimeve për përfshirjen e dyshuar të Avdylave në zgjedhje apo në korrup-



Kryetari i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako

sion me sektorë të ndryshëm të administratës.

Në tetor 2018, prokuroria deklaroi se po hetonte edhe veprimtarinë e kryebashkiakut të Durrësit, Vangjush Dako-por pa specifikuar konkretisht se për çfarë. Dy prokurorët e çështjes, Vladimir Mara dhe Dritan Prençi refuzuan të komentonin mbi ecurinë e hetimeve.

Dako nuk i ka mohuar bisedat telefonike me vëllezërit Avdyl dhe i ka paraqitur komunikimet me ta si të barabarta me qytetarët e tjerë që e mbështesin në zgjedhje.

I kontaktuar nga BIRN, Dako refuzoi të komentonte mbi marrëdhëniet e shtrira në kohë me vëllezërit Avdyl, mbi ç'mënyrë ishte ndihmuar prej tyre në zgjedhje apo nëse në këmbim, u kishte ofruar atyre zgjidhje të problemeve.

"Unë nuk jam marrë asnjëherë në pyetje nga Prokuroria," tha ai.

Vota, dreka dhe trafik influencë

Përpara se të shfaqte interes për kryebashkiakun Dako dhe procesin zgjedhor në qarkun e Durrësit, Astrit Avdyl, 45 vjeçari nga Shijaku që akuzohet nga Prokuroria e Krimeve të Rënda si kreu i grupit të organizuar në trafikun e drogës, kishte probleme të tjera.

I dënuar me 16 vjet burg për një vrasje të ndodhur në vitin 1997, Avdyl ndërmoi një betejë ligjore 10 vjeçare për lirim të parakohshëm nga burgu i Shënkolli-it dhe në fund i fitoi.

Dokumentet gjyqësore tregojnë se Astrit Avdyl u lirua pas 13 vitesh burg, pasi siguroi më parë një raport mjekësor që e diagnostikonte atë me "depression endogjen me tentativa suicidale [vetëvrasëse]. Ai doli nga burgu më 2 mars 2016, pasi Gjykata e Lartë urdhëroi lirin e tij me argumentin se "qëndrimi në burg i rrezikonte jetën".





U dënua me 16 vite për vrasje, pasi doli nisi trafikun e drogave të forta

# "Depresion, rrezikon vetëvrasje", si u lirua nga burgu Astrit Avdyli

Vangjush Dako pas zgjedhjeve: Doja ta falënderoja

← Të dhënat e sigurara nga BIRN tregojnë se vetëm pak kohë pas lirimt nga burgu, Avdyli u vendos nën hetim për përfshirje në trafikun e drogërave të forta. Për dy vjet e gjysmë, Prokuroria e Krimeve të Rënda kreu me qindra orë përgjime dhe ndërroi tre grupe prokurorësh, derisa në tetor 2018 ngriti akuza për 44 persona të akuzuar për trafik ndërkombëtar droge, korrupsion, ushtrim ndikimi të paligjshëm apo falsifikime masive me pronat.

"Veprimtaria kriminale ishte me qendër dhe pikë grumbullimi në qytetin e Shijakut, me referentë kryesorë vëllezërit Avdyli... strumbullarë të furnizimit me drogëra të forta, kryesisht heroinë dhe kokainë në të gjithë territorin kombëtar," thuhet në kërkesën e prokurorëve Dritan Prenci dhe Vladimir Mara.

Por ekskluziviteti i gjithëpranuar në trafikun e drogës nuk ishte i vetmi aktiviteti i kryer nga Avdulaj.

Përgjimet e siguruar nga BIRN, të cilat janë pjesë e dosjes ende nën hetim 339/1, tregojnë se Altin Avdyli, i njohur si Niçja, ka pasur komunikime të vazhdueshme telefonike me kryebashkiakun Vangjush Dako nga janari 2017 deri në shkurt të vitit 2018. Përgjimet tregojnë gjithashtu se dy vëllezërit Astrit dhe Altin Avdyli kanë drekuar të paktën dy herë me Dakon në fillim të vitit 2017.

Lidhja e kryebashkiakut me Avdulajit kulmoi megjithatë në prag të zgjedhjeve të 25 qershorit 2017, ku një bisedë e publikuar tashmë nga media, tregon përfshirjen e grupit të Shijakut në procesin zgjedhor.

Mbrëmjen e 24 qershorit, Altin Avdyli është përgjuar teksa komunikon me një person të panjohur, i cili i premtonte 6 vota dhe i kërkon që "t'i thotë Vangjushit që t'u japë ndonjë lek që të votojë".

Ditë pas zgjedhjeve, më 27 qershor 2017, Dako është përgjuar sërish teksa flet në

**HETIMI NË DIBER**  
Prokuroria e Krimeve të Rënda ka marrë nën hetim drejtues të policisë në Dibër dhe Bulqizë si dhe zyrtarë të drejtorisë Arsimore apo të Tatimeve, të cilët dyshohet se janë përfshirë në mënyrë të paligjshme në proces zgjedhor, se kanë premtuar vende pune në këmbim të votës.

janë përgjuar gjatë komunikimeve me vëllezërit Avdyli në fillim të vitit 2018, ndërkohë që këta të fundit kërkonin favore të llojeve të ndryshme.

Dokumentet tregojnë gjithashtu se vëllezërit Avdyli kanë komentuar apo ndjekur me interes zgjedhjet për presidentin e Federatës Shqiptare të Futbollit, ndonëse nga bisedat nuk del qartë se kush ishte kandidati i preferuar.

Bashkia e Durrësit rezultoi të jetë vetëm njëra prej zonave të influencës së grupit të dyshuar kriminal, ndërsa të dhënat hetimore tregojnë se ata janë përfshirë edhe në Kavajë. Ndërsa në Lezhë, përgjimet tregojnë se vëllai i ish-deputetit socialist Arben Ndoka flet gjithashtu për blerje votash.

"...Nga përgjimet e telefonave celularë në përdorim të shtetasit Gjevi Ndoka evidentohej se ky shtetas në bashkëpunim me persona të tjerë, si para dhe gjatë fushatës zgjedhore është përfshirë në mënyrë aktive duke ofruar dhe dhënë të holla (para) zgjedhësve për të votuar kandidatët për deputetë nën siglën e Partisë Socialiste, të dhëna këto që dalin nga përgjimet," shkruhet në dosjen hetimore.


Megjithatë, jo të gjitha transakcionet për votat kanë shkuar fllorë.

Një telefonatë e përgjuar dy ditë pas zgjedhjeve, të cilët hetuesit e çështjes e identifikojnë në zonën e Kavajës-por që BIRN nuk arriti ta verifikonte në mënyrë të pavarur, tregon jo vetëm fenomenin e blerjes së votës, por edhe fotografimin e saj dhe presionin për të kthyer paratë mbrapsht.

"Është filmue ajo punë, le tashi. Të më japë lekët mbrapsht Miri, ka mbaruar ai muhabet," thotë njëri prej biseduesve. "Ne i japim lekët me mbaru ato punë e halle që kenë, jo me dhanë lekë e mos me dhanë votën," shtohet aty, duke kërkuar që lekët të kthehen urgjentisht mbrapsht.

Makinaria e Dibërës  
Prej zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013, akuzat për lidhje të politikës me krimin dhe përfshirjen e grupeve kriminale në zgjedhje kanë qenë pjesë dominante e debatit politik në Shqipëri.

Partia Demokratike në opozitë i intensifikoi akuzat në zgjedhjet vendore të vitit 2015 dhe veçanërisht gjatë fushatës për zgjedhjet e 25 qershorit 2017-ku Partia Socialiste mori e vetme manda-



tin për të qeverisur vendin.

Aludimet për blerje të votës u reflektuan edhe në raportin e fundit të OSBE/ODIHR-it.

"Të dyja këto parti [Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim] treguan disa raste konkrete, por në mungesë të provave të njafatueshme konkluduese, nuk paraqitën ndonjë ankim ligjor kundër rezultateve. Megjithatë, ato iu përmbytën deklaratës së tyre të palëkundur se shkalles e blerjes së votës ishte e lidhur me sasi të mëdha parash të vëna në dispozicion nga kultivimi kriminal i drogës," shkruhet në raport.

Një hetim i dytë i Prokurorisë së Krimeve të Rënda, i nisur gjithashtu në vitin 2016 pas një kallëzimi të Partisë Demokratike për manipulim zgjedhjesh në Dibër ngre dyshime për përfshirjen e zyrtarëve lokalë dhe person-

ave me precedentë në shit-bleje të votës, premtime për vend pune dhe në disa raste, edhe përmes kanosjes.

Procedimi me nr:184/2016 lidhet me zgjedhjet e kryera më 11 shtator 2016 në Dibër për të zgjedhur pasardhësin e Shukri Xhelilit-i shkarkuar pasi u kap matë në një video-regjistrim ndërsa kërkonte favore seksuale në këmbim të një vendi pune.

Por zgjedhjet e reja, të cilat nxorën fitues mjekun socialist Muharrem Rama u përbalën nga akuzat për shit-bleje të votës dhe përfshirje të personazheve me të kaluar të errët në zgjedhje.

Në prag të zgjedhjeve, Partia Demokratike dorëzoi një kallëzim penal ndaj një morie drejtuesish lokalë të policisë, drejtorisë së Arsimimit, OSHEE-së, Tatimeve si dhe denoncoi publikisht Ymer Lalën, një personazh kontrovers me lidhje të forta në

zonë.

Por dy vjet e gjysmë pas këtij kallëzimi, çështja me nr: 184/2016 kaloi gjithashtu nëpër duart e disa prokurorëve dhe nuk është finalizuar ende.

Ish-prokurori Gentian Trenova, i cili mori i pari në dorë kallëzimin e Partisë Demokratike kujton për BIRN se menjëherë pas kallëzimit u vendosën nën përgjim rreth 20 numra telefoni.

"Përgjatë ditëve 8, 9 dhe 10 shtator u përgjuan me dhjetra telefonata, ku ndër të tjera flitej për blerjen e votës," tha Trenova, i cili shtoi se mes bisedave të përgjuara ndodheshin edhe zyrtarë të lartë të Partisë Socialiste.

Trenova u largua nga çështja, pasi u transferua nga Krimet e Rënda në Prokurorinë e Apelit të Tiranës. Çështja u ndodhet aktualisht mbi tavolinën e punës së prokurorit Klodian Braho.

Faksimile të përgjimeve

# PROTESTAT TAKIMET

Kreu i PD-së: Nuk ka më mjete politike, më 16 shkurt vendosin qytetarët

## Basha: Shqipëria sundohet nga një bandë, e rrëzojmë me 16 shkurt

"Rama fitoi 4 milionë euro vetëm për një ditë"

Valentina Madani

Kreu i opozitës Lulzim Basha u kërkoi dje banorëve të bashkisë së Kamzës që të bashkohen në protestën e 16 shkurtit para Kryeministrit. Basha theksoi se zgjidhja e problemeve në vend, mund të vijë sipas tij, vetëm nga populli dhe nuk është më në dorën e opozitës. Sipas tij, s'ka më mjete politike ndaj i ftoi qytetarët që vendosin vetë me 19 shkurt në marshimin drejt Kryeministrit. Politikisht kemi shteruar çdo mjet për zgjidhje. Ju e keni parë që të gjitha këto beteja politike kanë ndeshur në murin e mohimit nga Edi Rama dhe nga banda me të cilën sundon shqiptarët. Shqipëria sot nuk qeveriset, por sundohet nga një bandë. Në politikisht kemi shteruar çdo mjet për ta zgjidhur këtë. Prandaj kemi ardhur t'ju kërkojmë ndihmë. Ta zgjidhim siç e zgjidh çdo popull evropian. Kemi ardhur t'ju kërkojmë ndihmë, sepse zgjidhja tani nuk është më në duart e një partie politike apo të një aleance opozitare, zgjidhja është në duart e qytetarëve shqiptarë. Ju ftoj që me zgjidhjen në mendjen dhe shpirtin tuaj të vini e të marshoni më 16 shkurt në Tiranë", deklaroi z.Basha. Kreu i PD-së akuzoi qeverisjen për vjedhje të fondeve dhe premtime të pambajtura. Duke u referuar përmbajtjeve të zonave në bashkinë Kamëz, kreu demokrat akuzoi Ramën se po tallet me këta banorë. "Edi Rama ka fituar 4 milionë euro vetëm për një ditë. Uji, kthehet në mallkim për njerëzit e thjeshtë dhe kthehet në pasurim për Edi Ramën. Qeverisja e tij përkufizohet 'Merri shumicës dhe jepi vetes tënde!' Edi Rama tallet me familjet e përmbytura, sikurse tallet me të gjithë shqiptarët", u shpreh Lulzim Basha. Gjatë takimeve, Basha u prezantoi banorëve platformën e opozitës për ekonominë, shëndetësinë apo dhe punësimin. "Ne i kuptojmë shumë mirë prioritetet e vendit dhe kemi zgjidhje konkrete për



Kreu i opozitës, Lulzim Basha, dje në Bathore

### DEKLARATA

"Politikisht kemi shteruar çdo mjet për zgjidhje. Ta zgjidhim siç e zgjidh çdo popull evropian. Kemi ardhur t'ju kërkojmë ndihmë, sepse zgjidhja tani nuk është më në duart e një partie politike apo të një aleance opozitare, zgjidhja është në duart e qytetarëve shqiptarë", - tha z.Basha.

## Ndryshohet VKM-ja për banorët e Unazës, qira deri në momentin e strehimit

Qeveria ka vendosur të ndryshojë vendimin për banorët e Unazës së Re që preken nga projekti i ndërtimit të rrugës. Sipas VKM-së, banorët e Unazës së Re në vend të periudhës dy vjeçare të qerasë së paguar, do të përfitojnë nga programi social i strehimit pagesën e plotë të qirasë, nga momenti i mbarimit të afatit të përcaktuar. Ndryshe nga vendimi i parë që parashikonte qira për një periudhë dyvjeçare për banorët që u shemben ndërtesat, në vendimin e djeshëm, ndryshohen fjalët "... përfitojnë pagesën e qirasë për një periudhë dyvjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi", e cila zëvendësohet me "...përfitojnë nga programi social i strehimit pagesën e plotë të qirasë, nga momenti i mbarimit të afatit të përcaktuar deri në sistemin me strehim në një nga programet që parashikon ligji për strehimin". Sipas vendimit, financimi i qirasë për



### PROTESTA

Banorët e Unazës së Re protestuan edhe mbrëmë kundër projektit që shemb banesat e tyre. Nën thirrjet: 'Rama kriminel i këtij vendi! Do vijmë të ta gjejmë shtëpinë', banorët i kanë bërë apel kryeministrit që të tërheqë menjëherë projektin ose përndryshe ka për ta pësuar keq. Në mbështetje të tyre kanë shkuar edhe deputetë e opozitës.

familjet përfituese mbulohet 50% nga buxheti i shtetit, që akordohet për strehimin dhe 50% nga buxheti i Bashkisë Tiranë. "Financimi i qirasë të bëhet pas verifikimit nga Bashkia Tiranë të gjendjes ekonomike dhe

sociale të familjes, sipas parashikimeve të ligjit për strehimin", thuhet në VKM. Banorët e Unazës së Re protestojnë prej muajsh kundër vendimit që shemb ndërtesat e tyre pa i dëmshpërlyer.

vendin. Kemi zgjidhje për ekonominë që sot është në kolaps për shkak të një njeriu që vjedh brenda një dite 4 milionë euro nga pasuria publike. Kemi zgjidhje për

papunësinë që është plaga më e madhe e familjeve. Nuk kërkojmë mëshirë, nuk kërkojmë lëmoshë. Janë katandisur në këtë ditë, shumë prej këtyre familjeve që nuk mar-

rin ndihmë sociale, sepse nuk ka punë, jo sepse nuk duan të punojnë. Ne kemi zgjidhje për t'i dhënë fund papunësisë, për të hapur vende pune me paga dinjitoze. Ne kemi zgjidhje për



Një nga protestat e opozitës

### AKUZA

"Edi Rama ka fituar 4 milionë euro vetëm për një ditë. Uji kthehet në mallkim për njerëzit e thjeshtë dhe kthehet në pasurim për Ramën. Qeverisja e tij përkufizohet 'Merri shumicës dhe jepi vetes tënde!'. Rama tallet me familjet e përmbytura, sikurse tallet me të gjithë shqiptarët", deklaroi kreu i PD-së.



Hartimi i ligjit, PD ngre grup pune me ekspertë

## Ligji i ri për arsimin, Boçi: Do të jetë produkt jo politik

PD ka ngritur një grup pune për hartimin e një ligji të ri si alternativë. Komisioni përbëhet nga deputetë dhe ekspertë të fushës, ndërsa do të hidhet për konsultim të gjerë në publik dhe me grupet e interesit. Deputeti, Luçiano Boçi, pjesë e grupit të punës, tha dje për OraNews se një fokus të veçantë do të ketë mënyra se si trajtohet studentit përfshirë edhe tarifën. "Ripozicionimi i studentit, i cili nuk duhet të jetë më ai klienti që i merren dhe të shkoqur nga xhepi, siç bën kjo qeverisje. Pra, integrimin e tij në tërësinë e botës akademike, jo refuzimin e tij dhe parjen e tij si një dërgesë nga jashtë që mban në këmbë Universitetin. Ligji i ri që pritet të dalë nga Komisioni i ngritur nga PD-ja, vjen si platformë arsimit për nesër në qeveri, por deputeti Luçiano Boçi shpreh se në goftë se qeveria do të reflektojë, ai mund të ofrohet si zgjidhje pa humbur kohë. "Do të jetë një produkt që nuk është politik, por është në radhë të parë akademik, studentor. Është ai ligj i cili është i domosdoshëm për situatën dhe që ndërton njëkohësisht një të ardhme për Universitetin, një të ardhme për kërkimin shkencor", deklaroi Boçi.

shëndetësinë që është në kolapsin e vetë më të keq, nga njëra anë, sepse lekët e shëndetësisë i marrin 3-4 oligarkë, dhe nga ana tjetër, sepse infermierët dhe mjekët po lar-

gohen nga Shqipëria. Por këto zgjidhje nuk mund të zbatohen pa marrë një zgjidhje të madhe për problemin që ka Shqipëria", deklaroi z.Basha.





Rama e konsideroi si një nga njerëzit më të ditur, "ministri" i Jashtëm zotëron 5 diploma

# Ministria publikon CV-në, Gent Cakaj 3 diploma master për 3 vite

Profili i tij është publikuar 1 muaj pas propozimit

Gati 1 muaj nga propozimi si ministër i Jashtëm dhe dy javë nga marrja "de facto" e detyrës si kreu i diplomacisë shqiptare, Gent Cakaj ka tashmë një profil të tij në faqen zyrtare të Ministrisë së Jashtme. Ministria e Jashtme ka publikuar dhe CV-në e tij shoqëruar edhe me një foto zyrtare. Ndërsa të gjithë ngritën dyshime mbi figurën dhe kapacitetin e tij, kjo edhe për shkak të moshës së tij të re, kryeministri Edi Rama, ndërsa i doli në mbrojtje, e konsideroi atë si një nga njerëzit më të ditur, edhe se vetë Presidenti i Republikës që refuzoi ta dekretojë. Ndërkohë që në një dalje për mediat Rama do ta konsideronte atë edhe si një nga njerëzit më të lexuar. "Gent Cakaj ka lexuar libra më shumë se sa keni thënë fjalë ju të gjithë në dispozicion. CV-në e tij ju do ta keni në dispozicion sapo të bëhet ministër. Të jeni të sigurt që zgjedhja e tij është zgjedhja e një shqiptari si unë. Unë e neveris çdo kënd që nënvizon kosovarin si arsye për të kontestuar zgjedhjen. E neveris! Ai është një ndër njerëzit më të ditur që kam takuar në jetën time". tha Rama pak kohë më parë ndërsa iu përgjigj interesit të gazetarëve, sepse Cakaj nuk kishte një CV të publikuar. Dhe natyrisht që për këtë kryeministri i është referuar pikërisht shkollimit të tij. Siç bëhet ditur në CV-në e tij rezultoni se Cakaj është i datëlindjes 1990 dhe është zotëues i 5 diplomave, nga të cilat 1 master dhe 2 Bachelor brenda 3 vitesh. Studimet universitare i ka kryer për filozofi në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Prishtinës (2012) dhe drejtësi në Fakultetin Juridik të Universitetit AAB në Prishtinë (2016). Ndërkohë që ai është diplomuar me titullin Master në shkencat politike nga Universiteti i Evropës Qendrore në Budapest, Hungari (2015) dhe me gradën Master i Filozofisë nga Instituti i Filozofisë të Universitetit të Leuven-it, në Belgjikë (2014).



Zv.ministri i Jashtëm Gent Cakaj

**RENDITJA**  
CV-ja e tij është publikuar së bashku edhe me një foto zyrtare të tij në faqen zyrtare të Ministrisë së Jashtme, ndërsa ai është renditur i pari ndërmjet zëvendësministre të tjerë, duke treguar kështu edhe një lloj hierarkie mes tyre.

## Rama zëvendëson Cakajin, Dedja zëvendësministër i Jashtëm

Ministria e Jashtme do të funksionojë tashmë me 4 zëvendësministra. Përveç Gent Cakaj, Artemisa Dralot dhe Etjen Xhafës, kjo ministri do të ketë edhe një zëvendësministër të ri. Ai është Sokol Dedja, emërimi i të cilit është miratuar dhe në mbledhjen e qeverisë. Sokol Dedja ka qenë më herët drejtor për BE-në pranë Ministrisë së Jashtme. Ai mban titullin "Doktor" të dhënë nga Universiteti i Ghent, Belgjikë dhe titullin "Master" në Studime të BE (2003) në Universitetin e Sussex, Britani e Madhe, diplomat karriere në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ku është drejtor i Drejtorisë së Bashkimit Evropian, ndërsa ka dhe një përvojë në mësimdhënie. Dedja, në fakt, do mbulojë pikërisht fushën e vepërimit që më parë e mbulonte Gent Cakaj, i cili tashmë ndonëse si zëvendësministër do të luajë dhe rolin e ministrit të Jashtëm. Presidenti Ilir Meta refuzoi të dekretojë si ministër të Jashtëm Gent Cakajin, ndërsa pas këtij veprimi të Presidentit, kryeministri Edi Rama vendosi të marrë vetë këtë post. Pas betimit edhe si ministër i Jashtëm në presidencë, Rama i delegoi kompetencat Gent Cakajit duke e bërë "de facto" ministër të Jashtëm.

## Delegimi, vendimi Ramës nuk është botuar në Fletoren Zyrtare

Ndonëse kanë kaluar gati dy javë nga delegimi i kompetencave të ministrit të Jashtëm nga Edi Rama te Gent Cakaj, vendimi i kryeministrit nuk është botuar ende në Fletoren Zyrtare. Sipas ligjit, vendimi për delegimin e kompetencave duhet të botohet në Fletoren Zyrtare, duke përcaktuar edhe afatet e ushtrimit të kësaj detyre, për të marrë kështu edhe fuqi ligjore. Kjo nënkupton se kryeministri duhet të përcaktojë edhe datën si afat final të ushtrimit të detyrës nga ana e zv.ministrit Cakaj si ministër i Jashtëm në arenën ndërkombëtare. Kodi i Procedurës Administrative parashikon delegimin e kompetencave. Një praktikë e tillë bëhet pothuajse nga të gjithë drejtuesit e institucioneve, ministra apo zyrtarë të tjerë, të cilët për një periudhë kohe ia kalojnë kompetencat vartësve të tyre. Ky vendim duhet të përbëjë si rregull edhe afatet e ushtrimit të detyrës që i delegohet. Neni 28 i këtij Kodi përcakton se "Përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe, organi që delegon një kompetencë nuk mund të autorizojë organin e deleguar apo të nëndeleguar, që ky i fundit t'ia nëndelegojë këtë kompetencë një organi tjetër. Ndërsa neni 29 parashikon se "Në rastet e delegimit, organi delegues përcakton kompetencat, të cilat janë deleguar ose tregojnë se çfarë aktesh mund të nxjerrin apo të zbatojnë organet e deleguara. Delegimi i kompetencave botohet në Fletoren Zyrtare".

### CV, JA KUSH ËSHTË I RIU NGA KOSOVA QË DREJTON MINISTRINË E JASHTME

Gent Cakaj ka lindur në Prishtinë, më 6 korrik 1990. Gent Cakaj është shkolluar në Kosovë, Belgjikë dhe Hungari. Në vitin 2017, Gent Cakaj ka marrë gradën Master Shkencor në Filozofi, duke u diplomuar me rezultate të shkëlqyera nga Universiteti i Leuven-it në Belgjikë. Qendra për Metafizikë, Filozofi të Religjionit dhe Filozofi të Kulturës të Institutit të Filozofisë të këtij universiteti. Gent Cakaj mban edhe katër diplomime të tjera në fushat e filozofisë, drejtësisë dhe shkencave politike. Ai është diplomuar me titullin Master në shkencat politike nga Universiteti i Evropës Qendrore në Budapest, Hungari (2015) dhe me gradën Master i Filozofisë nga Instituti i Filozofisë të Universitetit të Leuven-it, në Belgjikë (2014). Studimet universitare i ka kryer për drejtësi në Fakultetin Juridik të Universitetit AAB në Prishtinë (2016), si dhe studimet për filozofi në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Prishtinës (2012). Gent Cakaj ka një ekspertizë të thellë në Analiza Politike dhe Politika Krahasese, në Filozofi Moderne dhe Metafizikë, për të cilat është certifikuar nga Universiteti i Evropës Qendrore në Hungari dhe nga Universiteti i Leuven-it në Belgjikë. Gjatë viteve të shkollimit, Gent Cakaj është angazhuar si konsulent dhe analist për çështje politike, si dhe është autor e bashkëautor i disa punimeve në këto fusha, botuar nga shtëpia botuese e Universitetit të Pitsburgut në SHBA (2016) dhe së shpejti edhe nga shtëpia botuese prestigjioze Brill (2019). Në janar 2018, Gent Cakaj i është bashkuar Kabinetit të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë si këshilltar politik, përgjegjës kryesisht për procesin e integritimit evropian dhe politikës së jashtme. Në të njëjtën kohë, ai ka shërbyer edhe si Koordinator Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Zonën Rajonale Ekonomike për Ballkanin Perëndimor. Në qershor 2018, Gent Cakaj emërohet zëvendësministër në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, përgjegjës për çështjet që lidhen me procesin e integritimit të Shqipërisë në BE, si dhe Koordinator Kombëtar i procesit "screening" për hapjen e negociatave të Republikës së Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

it, në Belgjikë (2014). Në vitin 2017, Gent Cakaj ka marrë gradën Master Shkencor në Filozofi, duke u diplomuar, siç thuhet në CV, me rezultate të shkëlqyera

nga Universiteti i Leuven-it në Belgjikë. Qendra për Metafizikë, Filozofi të Religjionit dhe Filozofi të Kulturës të Institutit të Filozofisë të këtij universiteti. Pra,

në total ai deklaron se mban 5 diploma, nga të cilat dy në bachelor dhe tre të tjera në master në fushat e filozofisë, drejtësisë dhe shkencave politike. Në këtë CV ai deklaron se ka një "ekspertizë të thellë në Analiza Politike dhe Politika Krahasese, në Filozofi Moderne dhe Metafizikë, për të cilat është certifikuar nga Universiteti i Evropës Qendrore në Hungari dhe nga Universiteti i Leuven-it në Belgjikë". Ndërsa gjatë viteve të shkollimit, Gent Cakaj deklaron se është angazhuar si konsulent dhe analist për çështje politike, si dhe është autor e bashkëautor i disa punimeve në këto fusha. Në janar 2018, Gent Cakaj i është bashkuar Kabinetit të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë si këshilltar politik, përgjegjës kryesisht për procesin e integritimit evropian dhe politikës së jashtme. Në të njëjtën kohë, ai ka shërbyer edhe si Koordinator Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Zonën Rajonale Ekonomike për Ballkanin Perëndimor dhe në vitin 2018 është emëruar në postin e zëvendësministrit. CV-ja e tij është publikuar së bashku edhe me një foto zyrtare të tij në faqen zyrtare të Ministrisë së Jashtme, ndërsa ai është renditur i pari ndërmjet zëvendësministre të tjerë, duke treguar kështu edhe një lloj hierarkie mes tyre.

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbaues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 25.02.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shpjetën e pasurisë së paluajtshme, Arë me sip.1.500 m<sup>2</sup> me nr. 179/87, vol. 8, fq. 19 zk. 2326, në Kuman, Fier në pronësi të Z. Arben Refat Ramizi me vlerë filltare në ankand 378,000 (Treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbaues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 27.02.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shpjetën e pasurisë së paluajtshme. Truall me sipërfaqe totale 112 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durres me Nr.pasurie 16136, Vol.6, Fq.122, ZK 8516 në pronësi të Shoqëria "ADRIATIKA BËTON" S.H.P.K., me adresë Durres, me vlerë filltare në ankand 7.338 € (Shtatë mijë e treqind e tridhjetë e tetë mijë gjashtë) EURO dhe Pasuri e paluajtshme. Truall me sipërfaqe totale 1260 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durres me Nr.pasurie 16255, Vol.7, Fq.236, ZK 8516 në pronësi të Shoqëria "ADRIATIKA BËTON" S.H.P.K., me adresë Durres, me vlerë filltare në ankand 82.555 € (Tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**KUVENDI**  
**DEBATI**

Propozimi detyron prokurorinë të paraqesë prova për arrestimin e deputetëve

# Rregullorja, PS tërhiqet nga rikthimi i "imunitetit" të deputetëve

*"Nuk miratohen ndryshimet pa konsensusin e opozitës"*

Kuvendi ka rinisur debatin për ndryshimin e Rregullore së Kuvendit, ku propozimi më i rëndësishëm ka të bëjë me detyrimin e organit të Prokurorisë së Përgjithshme për të paraqitur prova kur kërkohet arrestimin e një deputeti, siç ishte edhe rasti i Sajmir Tahirit. Plot 1 vit pasi depozituan në Kuvend këto amendamente, socialistët kanë rihapur diskutimin për t'i miratuar ato. Por, ndryshe nga sa është rregull për të tilla propozime, diskutimi nuk është zhvilluar në Këshillin për Rregulloren dhe Mandatet, por në Komisionin e Ligjeve. Për të mbrojtur këto ndryshime në komision u paraqit vetë kryetari i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, ndërsa opozita kundërshtoi me forcë që ky diskutim nuk zhvillohet Këshillin e Rregullore, por në Komisionin e Ligjeve. Sa u përket ndryshimeve, Balla bëri të ditur se në total bëhet fjalë për më shumë se 60 amendamente, ku vetëm 12 prej tyre kishin ardhur nga socialistët. Ndaj, ai theksoi se drafti final që paraqitet për diskutim është hartuar me konsensusin e të gjitha palëve. Por, deputeti demokrat, Enkelejd Alibeaj tha se me ndryshimet në Rregullore, mazhoranca po tenton të rikthejë imunitetin e deputetit. Ai kundërshtoi pikërisht propozimin për riformulimin e nenit 118 të Rregullore së Kuvendit ku theksohet se "Kërkesa për autorizuar caktimin e masës së sigurimit të burg ose në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrollit personal apo të banesës së një deputeti."

"Një skifter vjen dhe na sjell si propozime çështjet e imunitetit. Qëllimi juaj është të riktheni imunitetin e deputetit. Doni të mbroini deputetët nga ndjekja penale. Kaq shumë kenë vjedhur? Kaq frikë ju ka kapur?", - u shpreh Alibeaj gjatë mbledhjes së komisionit. Por, kryetari i deputetëve socialistë, Taulant Balla u përgjigj duke u shprehur se drafti i propozuar ka marrë dakordësinë edhe të opozitës, dhe se propozimi në fjalë është marrë nga përcaktimi që bën Kushtetuta për këtë çështje.



Ballë dhe Bushati dje në Komisionin e Ligjeve

**BALLA**  
"Nuk kemi luksin dhe qytetarët shqiptarë nuk kanë pse të paguajnë 30 milionë lekë në vit për të mbajtur grupe parlamentare si ai i PR-së, ku shumica e deputetëve jepen borxh nga PD", - u shpreh Balla.



Gjatë një seance parlamentare

**DEKLARATA**



**PD: Detyruam Ballën të tërhiqet nga imuniteti i deputetëve**

Partia Demokratike deklaroi dje se detyroi mazhorancën që të tërhiqet nga propozimi që detyron prokurorinë që të paraqesë prova kur kërkohet arrestimin apo procedimin e një deputeti. Nëpërmjet një njoftimi për mediat që i referohet kryesisht qëndrimit që mbajti deputeti Enkelejd Alibeaj në Komisionin e Ligjeve, PD kërkoi që kjo tërheqje të vendoset në mënyrë zyrtare në Këshillin e Mandateve dhe Rregullore. "Opozita nuk dha konsensusin për rikthimin e imunitetit për deputetët, duke detyruar kreun e grupit parlamentar të PS, Taulant Balla të tërhiqet nga propozimi. Nisur nga praktika e mëparshme, opozita kërkoi që ky vendim të mos mbetet vetëm fjalë, por tërheqja të diskutohet dhe të vendoset në Këshillin për Mandatet dhe Rregulloren", - thuhet në njoftimin e PD. Sipas PD, çdo dispozite që rrit, shton imunitetin e deputetëve që janë në ndjekje penale, është e papranueshme për të. "Ju nuk respektoni Kushtetutën dhe Rregulloren siç duket ju ka mbetur vetëm një gjë, çështjen e imunitetit e deputetëve. Kjo e sotmja që po bëni ju, të fusni edhe një herë çështjen e imunitetit të hequr nga Kushtetuta në 2012-ën dhe e mbani mend që nuk donit ta hiquit imunitetin, sot po e fusni me dhunë. Frikën kush e ka? Po fusni imunitetin për të mbrojtur deputetët nga ndjekja penale", - tha Alibeaj në komision.

**PROPOZIMET E PS**

- Në nenin 13, pikat 3, 4, 5 dhe 6 ndryshojnë si më poshtë:**  
Këshilli shqyrton kërkesën e prokurorisë për dhënie e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin, heqjen e lirisë në çfarëdo lloj forme, ushtrimin e kontrollit personal apo të banesës së një deputeti.  
Procedura e detajuar parashikohet në nenet 118 dhe 119 të kësaj rregulloreje.  
Këshilli shqyrton të gjitha çështjet e vlefshmërisë së mandatit të deputetit që lidhen me fillimin dhe mbarimin e ushtrimit të mandatit, heqjen dorë nga mandati, kushtet e papajteshmërisë sipas nenit 70 të Kushtetutës, mungesën pa arsye për më shumë se 6 muaj rresht në Kuvend, dënimin me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Pas përfundimit të shqyrtimit, këshilli paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 2 javëve.  
Këshilli shqyrton rastet e pazgjedhshmërisë sipas nenit 69 të Kushtetutës si dhe bën verifikimin e mandatit të deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës kur krijohet vakancë, mbi bazën e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pas përfundimit të shqyrtimit, këshilli paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 2 javëve.  
Këshilli, si rregull, mbledhet në mënyrën e parashikuar nga kjo rregullore për komisionet e përhershme, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.
- Neni 118 riformulohet si vijon: Autorizimi për procedim**  
1. Kërkesa për autorizuar caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrollit personal ose të banesës, i paraqitet kryetarit të Kuvendit nga prokurori. Kërkesa përmban një relacion të arsyetuar dhe të shprehur me provat që mbështesin kërkesën.  
2. Kryetari i Kuvendit ia dërgon kërkesën dhe dokumentet shoqëruese menjëherë për shqyrtim Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin si dhe vë në dijeni Kuvendin dhe deputetin.  
3. Kryetari i Kuvendit pas konsultimit me Këshillin, cakton dy relatore për çështjen, respektivisht nga shumica dhe opozita parlamentare.  
4. Deputetit, ndaj të cilit kërkohet autorizimi për procedim, i vihet në dispozicion kërkesa dhe dokumentet që e shoqërojnë atë, si dhe i bëhet e ditur koha kur Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin do të fillojë shqyrtimin e kërkesës.  
5. Në mbledhjen e Këshillit për Rregulloren. Mandatet dhe Imunitetin merr fjalën Prokurori, i cili paraqet arsyet e kërkesës drejtuar Kuvendit. Pas paraqitjes së kërkesës, çdo anëtar i këshillit ka të drejtë t'i drejtojë pyetje prokurorit.  
6. Pas përgjigjeve të pyetjeve, kryetari i Kuvendit, i jep fjalën deputetit ndaj të cilit kërkohet autorizimi për procedim. Deputeti dhe ose përfaqësuesi i tij ligjor, ka të drejtë të paraqesë në këshill, me shkrim ose me gojë, shpjegimet dhe vërejtjet e tij rreth çështjes. Çdo anëtar i këshillit ka të drejtë t'i drejtojë pyetje deputetit.

Gjithsesi, ai bëri të qartë se këto ndryshime nuk do të miratohen pa konsensusin e deputetëve të djathtë, duke pranuar kështu se nëse opozita nuk jepte konsensusin për këtë propozim, atëherë ai nuk do të vendoset në rregullore. "Në këtë draft 6 propozime janë nga ne, 12 janë

nga opozita. Falënderoj Alibeajn që ka punuar për këtë dokument. Nuk miratohen ndryshimet në rregulloren e Kuvendit pa konsensusin e opozitës", - tha Balla. Ndërkohë që gjatë prezantimit të ndryshimeve kryesore, ai bëri të ditur se synohet ndër të tjera që të përcak-

tohet në muaj, një javë parlamentare kushtuar zgjedhësve, si dhe një seancë plenare dedikuar vetëm çështjeve që dalin nga takimet me ta. Gjithashtu, një tjetër propozim ka të bëjë me përcaktimin e detyrimit për të mos kaluar deputetë për parti të tjera vetëm që të krijohen

grupe parlamentare fiktive. "Nuk kemi luksin dhe qytetarët shqiptarë nuk kanë pse të paguajnë 30 milionë lekë në vit për të mbajtur grupe parlamentare si ai i PR-së, ku shumica e deputetëve jepen borxh nga PD", - u shpreh Balla. Një tjetër propozim, por i ardhur

nga demokratët është edhe ai që kërkohet të sanksionojë si veprimtari parlamentare bojkotin kur ai vjen si një vendim politik i grupit parlamentar. Në fund komisioni ra dakord që shqyrtimi i këtij projektvendimi të shtyhet për diskutim në mbledhjen e radhës.





Valentina Madani

Konferenca e Kryetarëve përmes debateve mes palëve rrëzoi dje kërkesën e opozitës për zgjatjen e afatit të komisionit hetimor parlamentar "Tahiri". Kërkesa për shtyrjen e afatit të Komisionit Hetimor "Tahiri" është refuzuar nga mazhoranca për shkak të kalimit të afateve ligjore, ndërsa opozita shprehet se organet e shtetit kanë refuzuar që t'i japin informacion. I ngritur në 15 mars të vitit të kaluar, Komisioni Hetimor Parlamentar për ish-Ministrin Tahiri përfundoi mandatin. Në afro 10 muaj u zhvilluan vetëm pak seanca, ndonëse Kuvendi kishte shtyrë afatin me 3 muaj. Kërkesa e opozitës për ta zgjatur edhe me 3 muaj të tjerë punimet e këtij komisioni u rrëzua në Konferencën e Kryetarëve. Nën kryetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka, deklaroi dje se hetimi do të zgjerohet, ndërsa Taulant Balla i bëri thirrje opozitës që të bëjë kërkesë ligjore për komision të ri. "Do dorëzojmë një tjetër kërkesë. Ka emrin e Tahirit komisioni, por lidhet me fenomenin, me emrat që kanë qenë dhe janë sot në qeveri. Hetimet do bëhen nga Rama e deri te Taulant Balla, jo vetëm për Tahirin. Lidhjet e qeverisë me krimin vijojnë të jenë problem madhor", - u shpreh z. Paloka. Mospranimin e kërkesës për shtyrje të afatit të komisionit ekzistues, Taulant Balla e justifikoi me bojkotin e opozitës, ndërsa u shpreh i hapur për të pranuar kërkesën e re të opozitës. "PD bashkë me LSI të sjellin në formën, siç e kërkon Kushtetuta dhe ligji kërkesën përsëri, me qëllim që të vijojë procesi hetimor siç e duan ata. Por në asnjë rast, qoftë Kushtetuta, qoftë ligji për komisionet hetimore, Rregulloja e Kuvendit nuk do të shkelet nga ana jonë se PD ishte në gjumë për dy muaj me radhë. Apeli im ka qenë, meqenëse nesër ngremë një tjetër komision hetimor të kërkuar nga Meta, kjo çështje të ndiqet, të hetohet sa më shpejt. Në 5 vitet e fundit i vetmi komision që ka dalë me raport është një i drejtuar prej nesh", - theksoi z. Balla. Por opozita bëri dje të qartë se kërkesën për ringritjen e Komisionit Hetimor do ta depozitojë brenda pak ditësh. "Ne jemi të vendosur, do ta ribëjmë kërkesën, komisioni do të ringritet dhe kësaj pune do t'i shkojmë deri në fund, sado të përpiqen ta pengojnë. Ka vetëm një qëllim, edhe pse Ruçi ju tërhoqi vërejtje formalisht institucioneve dhe u drejtua të deleguarës të

Komisioni, Balla: I ka skaduar mandati më 6 dhjetor. Paloka: Do kërkojmë ringritjen

# Mbyllet komisioni Tahiri, PD-PS përplasen për shtyrjen e afateve

Hetimi, opozita do bëjë një tjetër kërkesë



Komisioni parlamentar Hetimor për çështjen "Tahiri"



EDI PALOKA

"Do dorëzojmë një tjetër kërkesë. Ka emrin e Tahirit komisioni, por lidhet me fenomenin, me emrat që kanë qenë dhe janë sot në qeveri. Hetimet do bëhen nga Rama e deri te Balla, jo vetëm për Tahirin. Lidhjet e qeverisë me krimin vijojnë të jenë problem madhor", - tha Paloka.



TAULANT BALLA

"Në asnjë rast, qoftë Kushtetuta, qoftë ligji për komisionet hetimore, Rregulloja e Kuvendit nuk do të shkelet nga ana jonë se PD ishte në gjumë për dy muaj me radhë. Në 5 vitet e fundit i vetmi komision që ka dalë me raport është një i drejtuar prej nesh", - deklaroi z. Balla.



Zgjedhjet, Meta: Partitë shqiptare në Mal të Zi, veprim të mençur

Presidenti Ilir Meta e konsideron veprim të mençur të udhëheqësve politikë shqiptarë në Mal të Zi pas arritjes së një marrëveshjeje për koalicion të përbashkët parazgjedhor për zgjedhjet lokale të 3 marsit në Komunën e Tuzit. Komuna e Tuzit është krijuar pas shumë vitesh nga qeveria malazeze edhe me kërkesë së Tiranës zyrtare. "E përshëndes vendimin e mençur të udhëheqësve të subjekteve politike shqiptare në Malin e Zi për arritjen e marrëveshjes për formimin e një koalicioni të përbashkët parazgjedhor për zgjedhjet lokale të 3 marsit në Komunën e Tuzit. Duke u uruar suksese në këtë garë elektorale, jam besimplotë se kjo marrëveshje është një hap në drejtimin e duhur për fitoren dhe drejtimin e Komunës së Tuzit përmes bashkëpunimit, por edhe bashkëjetesës shembullore me malazezët dhe me të gjithë grupimet e tjera etnike", - u shpreh z. Meta.

## Akuza për parkingjet, bashkia: PD mashtroi qytetarët

### PD, akuza Veliajt: Po përgatit dy afera të mëdha korruptive

Partia Demokratike, akuzoi dje kryebashkiakun, Erion Veliajt, se po përgatit dy afera të mëdha korruptive: dhënien me koncesion të parkimeve në Tiranë dhe grabitjen e tokës publike tek Policia Bashkiake për interesa private. Zëdhënësjja, Ina Zhupa, deklaroi se këto vendime synojnë grabitjen e pasurive publike dhe të taksave të qytetarëve të Tiranës. "Erion Veliajt po përgatit dy afera të mëdha korruptive përpara se të lëshojë zyrën e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Afera e parë është dhënia me koncesion tek një firmë private e mbledhjes së të ardhurave nga parkimet me pagesë në Tiranë. Për të rrjepur më shumë nga lekët qytetarët e Tiranës, Veliajt do të vendosë disa pajisje për prerjen fizike të biletës. Ky shërbim do të paguhet ekstra nga qytetarët tek firma private që ka përzgjedhur Veliajt. Afera e dytë kor-



Zëdhënësjja e PD-së, Ina Zhupa

ruptive është e ngjashme me atë të Teatrit. Synon të vjedhë pronën publike për t'ia dhënë një firme private për ndërtim. Bëhet fjalë për një pronë të Bashkisë tek Policia Bashkiake, në rrugën e Kavajës, të cilën Veliajt ia ka premtuar një prej klientëve të tij. Por ky vendim nuk është në rendin e ditës së Këshillit bashkiak nesër, sepse Erion Veliajt nuk ka 38 votat që i duhen

"Erion Veliajt po përgatit dy afera të mëdha korruptive përpara se të lëshojë zyrën e kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Afera e parë është dhënia me koncesion tek një firmë private e mbledhjes së të ardhurave nga parkimet me pagesë në Tiranë.

për të bërë pazar me pronën publike", - deklaroi z. Zhupa. Po Bashkia e Tiranës vëren me keqardhje se PD përhap qëllimisht sipas saj një lajm të pavërtetë lidhur me mënyrën e administrimit të parkimit në qytet nga Tirana Parking. "Bashkia e Tiranës ka propozuar vendosjen e pajisjeve vetëshërbuese (automatë) dhe aplikacione të ndryshme, në vendet e destinuar për

parkim, të cilat mund të punojnë gjatë periudhës kur shërbimi i parkimit është aktiv, si një metodë e thjeshtë dhe efektive për verifikimin e tarifës së parkimit, njësoj si në çdo vend tjetër perëndimor. Ashtu siç funksionon edhe sot, pagesa që do të kryhet përmes këtij shërbimi do të kalojë 100% për llogari të Bashkisë së Tiranës", - bën me dije Bashkia.

radhës Spiropali që institucionet t'i përgjigjen parlamentarit. Jam i bindur që kjo histori do të vazhdojë kësh-tu, sepse nuk mundet as Rama dhe askush tjetër të demaskohen për lidhjet që

kjo qeveri ka direkt me krimin dhe drogën, sidomos gjatë kohës kur ministrinë e Brendshme e drejtonte Saimir Tahiri", - u shpreh Paloka. Komisionit që drejtohet nga demokrati Edi Paloka i

ka përfunduar afati që më 6 dhjetor, por opozita pretendon se disa organe shtetërore kanë penguar punën e këtij komisioni, duke mos dhënë informacione për hetimin e mëte-

jshëm. Kjo çështje solli debat dje në Konferencën e Kryetarëve. Por opozita, siç u shpreh nënkryetari i PD-së Paloka, nuk do të heqë dorë nga hetimi i çështjes "Tahiri" të nisur prej marsit 2018.

Shoqërohen 10 persona. Viktima qëndronte i ngjuar, dyshohet për vrasës me pagesë

# Hakmarrja godet sërish familjen Bilali, ekzekutohet në atentat ish-policia Arben Bilali

## 50-vjeçari u qëllua afër banesës me breshëri automatiku, mori 3 plumba në trup dhe në kokë

TIRANË

Hakmarrja godet sërish familjen Bilali në Tiranë. Ish-efektivi i policisë, Arben Bilali, i cili i mbijetoi një atentati në vitin 2010, u ekzekutua pasditën e djeshme me breshëri automatiku në zonën e Selitës në kryeqytet, pak metra larg banesës së tij. 50-vjeçari, i cili pohohet se ruhej prej kohësh u qëllua me 10 plumba nga persona ende të paidentifikuar, tekta su udhëtonte me automjetin tip "Hunday" e me targa AA867HX. Për pasojë ai ka mbetur i plagosur rëndë. Ndonëse është dërguar menjëherë në Spitalin e Traumës, ish-punonjësi i policisë nuk u ka mbijetuar plagëve të marra në kokë dhe në trup. Mësohet se Bilali u vra afër vendit ku 9 vite më parë u ekzekutua vëllai i tij, Leonard Bilali, ish-mundës i Dinamos. Krismat e armëve kanë shkaktuar panik, ndërkaq policia ka shkuar menjëherë në vendngjarje dhe ka nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake dyshohet se Arben Bilali të jetë ekzekutuar për hakmarrje, e cila vijon që prej 22 vitesh mes familjes së viktimës dhe një fis tjetër të njohur në atë zonë. Megjithatë, grupi hetimor po heton edhe në pista të tjera. Vrasja e 50-vjeçarit e çon në tre numrin e viktimave në familjen Bilali. Brenda dy dekadave janë ekzekutuar në tri atentate vëllezërit Bujar, Leonard dhe Arben Bilali, duke shkaktuar tragjedi në këtë familje.

**VRASJA**

Ish-oficerë i policisë, Arben Bilali, ndonëse prej kohësh i druhej një atentati të mundshëm, dhe nuk ka mundur t'i shmangët serialit të hakmarrjes. Rreth orës 14:35 ai ishte duke udhëtuar me automjetin tip "Hunday" drejt banesës së tij trekatëshe, kur tre persona që dyshohet se kanë qenë të maskuar i kanë zënë pritë në një rrugicë pranë shkollës "At Zef Pllumi" në Selitë. Autorët kanë hapur zjarr vdekjeprurës nga një automjet tip "Benz" me ngjyrë të zeze dhe me targa të falsifikuara në drejtim të objektivit të tyre. Për pasojë, 50-vjeçari Bilali ka marrë dy plumba në trup dhe një në kokë, të cilët i shkaktuan vdekjen. Pas ekzekutimit, autorët e krimit janë larguar me shpejtësi në drejtim të Unazës së Re, gka tregon se ata e kanë njohur mirë zonën. Ngjarja ka tronditur banorët e zonës, pasi ka ndodhur në kohën kur ka pasur lëvizje të shumta. Ndërkaq, forca të shumta policore kanë rrethuar vendin ku ndodhi vrasja në Selitë, ndërsa janë ngritur post-bloqe të shumta në disa zona të kryeqytetit.



Vendi ku ndodhi vrasja



Ish-policia, i vrarë Arben Bilali dhe banesa e tij

### KUSH ËSHTË VIKTIMA

Arben Bilali, i cili u ekzekutua dje ka qenë punonjës policie të komisarit nr.2 si dhe efektiv i Repartit të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSh) në Tiranë, detyra nga të cilat është larguar disa vite më parë. 50-vjeçari është vëllai i tretë në familjen Bilali, që ekzekutohet në atentat. Viktima e parë në këtë familje ishte Bujar Bilali, i cili u vra në një atentat në vitin 1997. Ndërsa, vëllai më i vogël, Leonard Bilali (ish-mundës i Dinamos) u ekzekutua më 10 gusht të vitit 2010. Vetëm pak muaj para vrasjes së këtij të fundit, Arben Bilali mbeti i plagosur, por i mbijetoi atentatit.

10

### TË SHOQËRUAR

Policia e Tiranës ka ngritur një grup të posaçëm hetimor për zbardhjen e kësaj ngjarjeje të rëndë, ku pjesë e tij janë edhe oficerë të Shërbimit për Çështje të Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA). Bashkëshortja e viktimës është punonjëse policie dhe aktualisht punon në Drejtorinë e Policisë së Tiranës dhe nuk përjashtohet edhe një konflikt për shkak të detyrës. Për ngjarjen policia e kryeqytetit ka shoqëruar rreth 10 persona si të dyshuar, mes të cilëve edhe një anëtar të familjes me të cilin ishin në konflikt Bilalit.

## Zinxhiri i vrasjeve nisi në vitin e mbrapshtë të '97-ës

## Mallkimi i hakmarrjes, ja si u ekzekutuan 3 djemtë e familjes Bilali në harkun kohor të 22 viteve



Viktima Leonard Bilali

atentatit si dhe disa dëshmitarë të tjerë, të cilët mendohet se kishin dijeni mbi rrethanat e ngjarjes. Gjithashtu, blutë bënë me dije në atë kohë se 41-vjeçari Arben Bilali kish të marrë dy plagë, një në bark dhe tjetër në gjok nga të shëtitat e një personi të panjohur, që ishte larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes pas realizimit të atentatit të parë. Për më tepër, pak muaj më pas dhe konkretisht më 10 gusht të vitit 2010, u ekzekutua në një tjetër atentat Leonard Bilali, më i vogli i vëllezërve. Viktima, i cili kishte vetëm pak ditë që ishte kthyer nga Italia ku qëndronte si emigrant u qëllua për vdekje me 4 plumba pistolette në një nga lokalet në rrugën "Irfan Tomini" në kryeqytet. Ish-

mundësi i Dinamos u dërgua në gjendje të rëndë në Spitalin Ushtararak, ku ndërroi jetë si pasojë e plagëve të rënda të marra në kokë dhe në trup. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, policia bëri me dije në atë kohë se autori e ka qëlluar një herë në bark Bilalin dhe kur si pasojë e goditjes 33-vjeçari është përkulur, e ka qëlluar edhe 3 herë të tjera nga pas, në krahu e majtë. Autori është larguar në këmbë, ndërsa u dyshua se ishte ndihmuar edhe nga persona të tjerë për t'u larguar nga vendi i ngjarjes. Pavarësisht hetimeve të kryera, vrasjet e vëllezërve Bujar e Leonard Bilali janë ende pa autor.

Ndërsa, dyshohet se atentatorët janë vrasës me pagesë.

### NGUJIMI I FAMILJES BILALI

Banesa e ish-punonjësit të policisë, i cili u ekzekutua ditën e djeshme ruhej nga kamera të shumta sigurie, pasi i druhej një atentati të mundshëm. Pas vrasjes së dy vëllezërve të tij, Arben Bilali ishte ngjuar në banesën e tij në zonën e Selitës dhe nuk dilte shpesh. Policia ka sekuestruar mbi 30 kamera sigurie që nga "Vasil Shanto" deri në vendngjarje. Ndërsa, mësohet se një kamera sigurie e një biznesi ka filmuar momentin e vrasjes së ish-efektivit të policisë, Bilali.

30

### KAMERA SIGURIE

Banesa e ish-punonjësit të policisë, i cili u ekzekutua ditën e djeshme ruhej nga kamera të shumta sigurie, pasi i druhej një atentati të mundshëm. Pas vrasjes së dy vëllezërve të tij, Arben Bilali ishte ngjuar në banesën e tij në zonën e Selitës dhe nuk dilte shpesh. Policia ka sekuestruar mbi 30 kamera sigurie që nga "Vasil Shanto" deri në vendngjarje. Ndërsa, mësohet se një kamera sigurie e një biznesi ka filmuar momentin e vrasjes së ish-efektivit të policisë, Bilali.

### HETIMET

Ekzekutimi ditën për diell i ish-efektivit Arben Bilali ka alarmuar policinë, e cila në bashkëpunim me prokurorinë e kryeqytetit po hetojnë intensivisht për zbardhjen e

ngjarjes së rëndë. Hetuesit e çështjes dje bënë me dije se pista kryesore e hetime është ajo e hakmarrjes, por po hetohet edhe në pista të tjera. Ish-oficeri i policisë ka qenë akuzuar disa vite më parë për

vrasjen e një 41-vjeçari, por në ngarkim të tij nuk gjëftën asnjëherë prova të mjaftueshme për ta fajësuar. Po të njëjtat burime pohuan se dyshohet që atentatorët e kanë mbajtur prej kohësh

nën vëzhgim 50-vjeçarin, duke ndjekur lëvizjet e tij, për të arritur në eliminimin e tij fizik pasditën e djeshme. Në lidhje me ngjarjen në fjalë janë shoqëruar dhe marrë në pyetje 10 persona të dyshuar.



Zbërthehet skema e futjes së drogës nga Amerika Latine në vendin fqinj

ITALI

Një sasi rekord ko kaine me destina cion Italinë u sekuestrua falë një operacioni ndërkombëtar. Agjentë të infiltroar, në bashkëpunim me Guardia di Finanza, policinë zvicerane dhe DEA-n amerikane, shkatërruan organizatën me 5 anëtarë mes të cilëve një shqiptar: 644 kg kokainë u kapën në portin e Livornos. Malli ishte i ndarë në 582 pako në 23 çanta të fshihura brenda një konteneri me kafë dhe ishte në bordin e një anijeje portugeze nga Algericas, Spanjë ndërsa sasia totale që do të hynte në Itali ishte prej 7 tonë kokainë e pastër kishte një vlerë prej 10 milionë euro. Shtetasi shqiptar Dorian Petoku i përfshirë në trafikun ndërkombëtar u arrestua mbrëmjen e të martës në një lokal në zonën e ish-blokut. Policia italiane i kërkoi asaj shqiptare ta arrestonte Petokun me qëllim ekstradimi, teksa gjykatë e Romës ka vendosur ndaj tij masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Organizata kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike".

**SKEMA E DROGËS**

Kreu i organizatës konsiderohet italiani Salvatore Casamonica 43 vjeç, tashmë në burg me regjimin "416 bis", bashkë me të personi që e strehonte Silvano Mondolesi dhe dy persona të rrezikshëm, një shqiptar Dorian Petoku 31 vjeç dhe një malazez Tomislav Pavlovic 40 vjeç që merreshin me transportin e mallit. Pjesë e grupit është edhe një tjetër shtetas italian që me sa duket priste mallin në Itali. Marcello Schiaffini 53-vjeç mësohet të jetë lënë në masën "arrest shtëpie". Mbi të pestë anëtarët e grupit rëndon akuzat e trafikut ndërkombëtar të kokainës. Sipas hetuesve rolin më specifik në këtë grup e ka luajtur Salvatore Casamonica.

# Tonelata kokaine në Itali, roli i shqiptarit Petoku

*Policia arreston në Tiranë pjesëtarin e organizatës*



ca. 43-vjeçari konsiderohet si një prej anëtarëve të klanit të importit të drogës nga Amerika e Jugut. Ai mbante kontakte të drejtpërdrejta me kolumbianët, merrej me financimin e organizatës dhe organizimin e punës për importin e kokainës që do mbushte tregjet në Romë dhe Napoli. Silvano Mondolesi është konsideruar si roja i bosit të organizatës Salvatore Casamonica. Në verën e vitit 2018 ai u arrestua pasi u gjet në garazhin e vilës së tij në Castelli Romani, rreth gjysmë ton hashash, por me sa duket nuk reshiti kurrë së qeni krahu i djathtë i Casamonicas dhe ta ndihmonte atë në fazën e ndarjes dhe përpunimit, kur malli mbër-

rinte në Itali. Tomislav Pavlovic, malazez, i lindur në vitin 1979, njihet si një person me të kaluar kriminale. Ai në të kaluarën është akuzuar për grabitje armëmbajtje pa leje dhe trafik droge. Në këtë grup, siç thanë hetuesit italianë, ai kujdesej për sigurimin e logistikës së nevojshme për ta ruajtur drogën e më pas ngarkimin e saj në bordin e avionëve dhe importin e mëtejshëm drejt Evropës. Gjatë hetimeve rezultoi se ai kishte udhëtuar disa herë drejt Brazilit. Emri i tij ka dalë edhe në disa telefonata të përgjuara në kuadër të operacionit policor të koduar "World Mezzo", ku përshkruhej si një kriminel i rrezikshëm që përdorte armën

për të zgjidhur çështjet e mbetura pezull në biznesin e drogës. Dorian Petoku, nga ana tjetër, është një shtetas shqiptar, siç thonë mediat italiane, emri i të cilit ka dalë në hetime të shumta kundër trafikut të drogës. Ai konsiderohet, gjithashtu, si njëri që ka strehuar trafikantin e njohur Arben Zogu, bashkëkombas i tij, i cili aktualisht vuan

dënimin në burgun e Spoleto. Ashtu si kreu i organizatës Salvatore Casamonica edhe shqiptari thonë hetuesit kishte kontakte të drejtpërdrejta me organizatat e trafikut të drogës në Amerikën e Jugut, që të mundësonte trafikun e drogës nga Brazili në Itali. Ai bashkë me një person tjetër, siç thonë mediat italiane, u arrestua në Tiranë.

## Zgjidhen gjyqtarët për dosjen e Balilit, në krye një grua

**TIRANË** - Përcaktohet treshja e gjyqtarëve që do të marrin në dorë dosjen e të ashtuquajturit "Eskobari i Ballkanit", Klement Balili. Shorti është hedhur të martën pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe ka përcaktuar një trup të kryesuar nga Flora Hajredinaj. Pak ditë më parë avokati i Balilit, Theodhori Sollaku dorëzoi një kërkesë për gjykim të shkurrtar, por seanca e parë tek Krimet e Rënda u ndërpre me pretendimin se Balili ka dashur që ta bëjë personalisht këtë kërkesë. Dorëzimi i Klement Balilit ndodhi pikërisht në momentin kur dhe Prokuroria për Krimet e Rënda sapo ka mbyllur hetimet dhe ka dërguar dosjen për gjykim. Ai akuzohet për "Trafikim të lëndëve narkotike në bashkëpunim", "pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal", "Refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehje ose deklarim irremë i pasurive", si dhe për "Pastrim parash". Pas pothuajse tre vitesh arrati, Klement Balili u vetëdorëzua me 15 janar dhe kjo ngjarje bëri bujë jo vetëm në mediat vendase, por edhe ato ndërkombëtare. Vetëdorëzimi erdhi pas negociatave ku u përfshinë avokati i tij Theodhori Sollaku, drejtori i Policisë së Shtetit Ardi Veliu si dhe nipit i tij, i cili mban dhe postin e kryetarit të bashkisë Delvinë, Rigels Balili. Kreu i policisë Ardi Veliu shkoi vetë në Delvinë për të ekzekutuar masën e sigurisë "arrest me burg" dhënë nga gjykata. Ndërkohë në mesditën e 15 janarit Balili u transferua në Tiranë i shoqëruar nga drejtues të lartë të policisë së shtetit dhe eskortë me policë civilë. Fillimisht u bë ndalesë tek Komisarjati nr 6, Tiranë, ku qëndroi për 30 minuta më pas u vendos në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Tiranës.

**SHKURT**

**Lidhja me Habilaj, letra e ish-drejtorit**

**TIRANË** - Ish-shefi i Policisë së Vlorës i dyshuar si garantor i grupit të "Habilajve" në trafikun e drogës, Jaeld Çela i ka dërguar një kërkesë Gjykatës së Krimeve të Rënda, ku kërkon të mbyllet hetimi ndaj tij. Jaeld Çela vijon të jetë në arrati prej më shumë se një viti, ndërsa Krimet e Rënda do të shqyrtojnë kërkesën e tij në datën 11 shkurt. Ish-zyrtari i policisë është shpallur në kërkim bazuar në një masë sigurie "arrest në burg" në mungesë në nëntor 2017. Sipas hetimeve, ish-drejtori i policisë ka mbajtur në përdorim 3 numra telefoni, në të cilat rezultoi se ka komunikuar me Florian Habilajn dhe Gentian Cekën, që është shoferi i ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri. Kjo nuk është hera e parë që Çela ankohet për zgjatjen e afatit të hetimit. Ai bëri të njëjtën kërkesë nga arratia në mars të vitit të kaluar, kur hasi në refuzimin e gjykatës.

**Tritoli në Nikël, zbardhet ngjarja,**

**2 në pranga**

**KRUJË** - Policia e Krujës zbardh dhe dokumenton ngjarjen e ndodhur mbrëmjen e së martës në Nikël ku shpërtheu një sasi tritol në mobilierën e shtetasit E.C. e për pasojë u shkakton dëme materiale. Në lidhje me këtë ngjarje janë arrestuar dy shtetas shtetas D.Xh. si autor i dyshuar dhe shtetas B.K. si dhe janë shpallur në kërkim dy të tjerë të dyshuar të përfshirë në ngjarjen e mësipërme, por për arsye hetimi policia nuk i bën me dije gjeneralitetet. Dy të arrestuarit akuzohen për "Shkatërimi i pronës me eksploziv" dhe "Mbatja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyeshe dhe municionit".

**Kapet shqiptari, ishte në kërkim për drogë**

**FIER** - Një shqiptar i shpallur në kërkim ndërkombëtar është arrestuar sot në qytetin e Fierit me qëllim ekstradimi drejt Italisë. Sipas policisë, i arrestuari është shtetas Aslan Fata, 41 vjeç, banues në Fier, ndaj të cilit gjykata e Milanos ka dhënë masën e sigurisë "arrest me burg" për veprat penale të trafikut të lëndëve narkotike. Veprimet e mëtejshme për këtë shtetas do të kryhen nga Zyra e Interpolit Tiranë, njofton policia.

**Vdiq në burgun grek, shqiptari varrosset sot në Sarandë**

**TRUPI** i shqiptarit Bardhyl Tursha që u gjet i vdekur në burgun e sigurisë së lartë në Koridhalo të Greqisë u varros dje në Shelegr të Sarandës. Ndonesë ai u nënshtrua ekspertizës mjeko-ligjore, shkaqet e saktë të vdekjes nuk janë vetë ende publike. Madje as bërë familjarët nuk kanë dashur të komentojnë ngjarjen. Dyshohet se vdekja mund t'i ketë ardhur nga abuzimi me drogën.

## Tërhiqet avokati i Nazer Seitit: "E kam të pamundur mbrojtjen"

**D**etar Hysi, mbrojtësi ligjor i Nazer Seitajt, heq dorë nga mbrojtja ndaj klientit të tij. Përmes një shkresë drejtuar Gjykatës së Krimeve të Rënda, Hysi thotë se e ka të pamundur ushtrimin e detyrës së tij për shkak të mos komunikimit me të pandehurin Nazer Seiti, i cili gjykohet në Itali. "Në vazhdim të përmblotjes së detyrës time si mbrojtës, në bazë të ligjit për avokatinë, ju njoftoj se nuk jam më mbrojtës dhe përfaqësues i këtij shtetasi, në secën gjyqësore paraprake më 04.02.2019 të caktuar nga ana juaj për gjykimin e kësaj kërkesë penale, për shkak të moskomunikimit me të pandehurin Nazer Seiti, pasi ai ndodhet me masë shtrenguese, sigurimi personal në shtetin Italian nga gjykata e Catanias. Në këto kushte e kam të pamundur vazhdimin e mbrojtjes." Shkruan avokati Hysi në shkresën drejtuar Gjykatës së Krimeve të Rënda. I konsideruar si financieri i grupit kriminal të drogës "Habilaj", Nazer Seiti u ekstradua në Itali në janar të 2018. Ekstradimi i tij shkaktoi përplasje të forta institucionale, madje pati dhe akuzat nga opozita se ai u largua për t'kuçur gojën, pasi kishte vendosur të fliste kundër ish-ministrit të Brendshëm. Nazer Seiti u arrestua në Babicë të Vlorës më 19 tetor të vitit të kaluar gjatë një operacioni antidrogë ku u sekuestruan rreth 4 ton kanabis.

United Nations Development Programme

**VACANCY ANNOUNCEMENT**

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancy.

**1- Post Title:** Outcome Coordinator on Employment  
 Deadline for Application: February 5, 2019

**2- Post Title:** Outcome Coordinator on Institutional Capacity Building  
 Deadline for Application: February 9, 2019

**3- Post Title:** Programme Coordinator  
 Deadline for Application: February 9, 2019

**Type of Contract:** Service Contract  
**Project:** Skills Development for Employment Programme  
**Duty Station:** Tirana, Albania  
**Duration of Assignment:** 1 year with possibility of extension

**Job Description:** <http://al.undp.org>  
 Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>.  
 Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.

Më 23 shkurt, Agjencia e Trajtitimit të Pronave do të ketë gati faturën financiare

# Pronat/Jonida Baçi: Ja si do të ndahen 50 miliardë lekë

## Ish-pronarët do të marrin 23 mijë hektarë tokë

Brenda datës 23 shkurt, Agjencia e Trajtitimit të Pronave do të përfundojë vlerësimin financiar të ta gjithë dosjeve të pronave. Në dispozicion të kompensimit financiar të pronarëve janë vënë 50 miliardë lekë, ndërkohë që është një sipërfaqe prej 23 mijë hektarësh tokë që do të shërbëjë për kompensimin fizik. Të dhënat janë bërë të ditura dhe nga drejtoresha e Agjencisë së Trajtitimit të Pronave, Jonida Baçi, gjatë një leksioni të hapur me studentët në UET, ku shpjegoi se sipas ligjit të ri, pronarët do të kompensohen në vlerën 20% të totalit në para dhe 80% në truall. Baçi sqaroi se në funksion të kompensimit të pronarëve, qeveria ka vënë një fond tokë prej 23 mijë hektarësh, si dhe një fond financiar prej 50 miliardë lekësh. Kreu i Agjencisë së Trajtitimit të Pronave e vuri theksin në numri shumë i ulët i aplikimeve dhe problematikat e mëdha me të cilat përballlet procesi i kthim-kompensimit të pronarëve, që nisin nga mbivendosjet për shkak të korrupsionit në vite, të dje-gjia apo vjedhja e kadastrave, deri te vendimet korruptive të gjykatave.

### KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK

Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duket të cilësojë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet: kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i apo vlerësimi të tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfutur ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

### LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondet financiar i kompensimit, deri në masën 50 për qind sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit

nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompensohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuar u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

### VLERËSIMI FINANCIAR

Ligji për trajtimin e pronave përcakton që ATP-ja, për efekt të kompensimit dhe të ekzekutimit të vendimeve përfundimtare, vlerëson financiarisht vendimet, duke u bazuar në vlerat e përcaktuara në hartën e vlerës dhe procedon, si më poshtë vijon: a) Vlerëson fi-

nciarisht pronën e njohur për kompensim, në bazë të zërit kadastral që ka pasur pronë në kohën e shpronësimit, duke u bazuar në hartën e vlerës. b) Vlerëson financiarisht pronën e kthyer, të kompensoar fizikisht apo të përfutur në një nga mënyrat e tjera sipas legjis-lacionit për kthimin dhe kompensimin e pronave, duke përcaktuar diferencën që do të rezultojë ndërmjet vlerës së saj sipas zërit kadastral aktual dhe vlerës së kësaj prone sipas zërit kadastral

në kohën e shpronësimit. c) Për vendimet që kanë njohur vetëm të drejtën për kompensim, vlerësimi do të bëhet në bazë të zërit kadastral që ka pasur pronë në kohën e shpronësimit, sipas shkronjës "a", më sipër. d) Zëri kadastral i origjinës së pronës përcaktohet duke u bazuar në dokumentacionin ligjor të administruar në dosje ose, në mungesë të këtij të fundit, për përcaktimin e zërit kadastral do të përdoret harta e kohës së shpronësimit dhe në mung-

METODA E VLERËSIMIT FINANCIAR

- ATP-ja, për efekt të kompensimit dhe të ekzekutimit të vendimeve përfundimtare, vlerëson financiarisht vendimet, duke u bazuar në vlerat e përcaktuara në hartën e vlerës dhe procedon, si më poshtë vijon:
  - a) Vlerëson financiarisht pronën e njohur për kompensim, në bazë të zërit kadastral që ka pasur pronë në kohën e shpronësimit, duke u bazuar në hartën e vlerës.
  - b) Vlerëson financiarisht pronën e kthyer, të kompensoar fizikisht apo të përfutur në një nga mënyrat e tjera sipas legjis-lacionit për kthimin dhe kompensimin e pronave, duke përcaktuar diferencën që do të rezultojë ndërmjet vlerës së saj sipas zërit kadastral aktual dhe vlerës së kësaj prone sipas zërit kadastral në kohën e shpronësimit.
  - c) Për vendimet që kanë njohur vetëm të drejtën për kompensim, vlerësimi do të bëhet në bazë të zërit kadastral që ka pasur pronë në kohën e shpronësimit, sipas shkronjës "a", më sipër.
  - d) Zëri kadastral i origjinës së pronës përcaktohet duke u bazuar në dokumentacionin ligjor të administruar në dosje ose, në mungesë të këtij të fundit, për përcaktimin e zërit kadastral do të përdoret harta e kohës së shpronësimit dhe në mungesë të saj, harta që është më e afërt me kohën e shpronësimit; në pamundësi objektive për përcaktimin e zërit kadastral, sipas kësaj shkronje, atëherë vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht me çmimin minimal, të përcaktuar në hartën e vlerës për atë njësi administrative dhe për atë kategori prone.
  - dh) Në rastet kur në hartën e vlerës mungon vlera e caktuar për zërin kadastral të origjinës, vlerësimi financiar i vendimit përfundimtar që ka njohur të drejtën e kompensimit bëhet duke marrë si referim vlera me të njëjtin zë kadastral, që ndodhet më afër pronës që do të kompensohet. Në rast se pranë pronës që do të kompensohet gjenden disa zëra kadastrale të njëjtë me atë të origjinës së pronës, me distancë të njëjtë dhe me vlera të ndryshme, atëherë, për referim në përllogaritje merret zona që ka çmimin më të lartë.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 01.03.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i l-rë për shitjen e pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr 5/229 , ZK. 8250, me sipërfaqe 137 m2 me adresë Tiranë, në pronësi Z.Bujar Musa Kajtazi me vlerë fillestare në ankand 98.880 (Nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) EURO.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 4 22 31 888.



## Ahmetaj flet për ministrat e rinj: Njerëzit e duhur, ekip i fortë

Ish-ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, ka qenë dje në studion e "News 24" në rubrikën "Opinion" për të folur për ndryshimet në qeveri, por edhe raportin e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe gjendjen ekonomike. Ahmetaj tha se ndryshimet në qeveri ishin diskutuar me kryeministrin. Ai shprehu besim tek ekipi i ri, për të cilin tha se është një ekip i fortë me njerëzit e duhur, raporton "BalkanWeb". "Si erdhën, i patë. Nuk besoj se ishte e befashme. Kryeministri kishte besuar në mënyrë kolegjiale në parim nevojën e ndryshimeve në

**ISH-MINISTRI AHMETAJ**  
"Ndryshimet në qeveri ishin diskutuar me kryeministrin. Ai shprehu besim tek ekipi i ri, për të cilin tha se është një ekip i fortë me njerëzit e duhur, raporton 'BalkanWeb'.  
"Si erdhën, i patë. Nuk besoj se ishte e befashme. Kryeministri kishte besuar në mënyrë kolegjiale në parim nevojën e ndryshimeve në kabinet. Kemi biseduar qoftë në bisedat në kabinet, qoftë në kryesi".



Ish-ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

kabinet. Kemi biseduar qoftë në bisedat në kabinet, qoftë në kryesi. E rëndësishme është se ekipi i ri është një ekip shumë i mirë në këndvështrimin tim personal me një bagazh ekspe-

rience të konsiderueshëm. Mendoj që ekipi i ri është i duhuri, mund ta them pa frikë që është një ekip i fortë në gjithë sektorët kyçë. Në pak muaj do shohim një përshpejtim qoftë në anën

sektoriale, qoftë në tërësi. Për mua nuk është kusht të ishin të njohur në politikë. Në finale mendoj që është zgjedhje e maturuar. Janë personalitete në fushat e tyre profesionale. Kjo pje-

sa nëse janë të njohur nga ana politike, s'ka rëndësi. Mendoj se është ekip i mirë. Brenda grupit ka një efekt pozitiv nga ndryshimet. Kanë një eksperiencë të madhe në administrim. Së

bashku mund të formatojnë reforma. Në aspektin e ndryshimeve është mënyra e duhur, koha e duhur, njerëzit e duhur. E padiskutueshme", deklaroi Ahmetaj.

Borxhi buxhetor për Partneritetet Publik-Privat kthehet në rrezik për buxhetin


# Eurostat: Shqipëria, me detyrimet më të larta në Europë për PPP-të

"Nuk janë përfshirë në borxh, është 1.9 miliardë lekë"

Borxhi buxhetor për Partneritetet Publike Private kthehet në rrezik për buxhetin. Janë rreth 1.9 miliardë lekë të përfshira në llogaritjen e borxhit publik, të cilat mund të kthehen në rrezik potencial për financat publike. Pas Fondit Monetar Ndërkombëtar është Eurostat, institucioni që ngre alarmin për rreziqet e PPP-ve për financat publike. Eurostat publikoi dje listën e vendeve të BE-së sipas detyrimeve potenciale jashtë bilancit për kontratat me Partneritet Publik Privat në raport me PBB. Vlerat përfaqësojnë shumën e financimeve që do të financojë buxheti i këtyre vendeve për kontratat PPP dhe që nuk janë llogaritur në borxh. Sipas Eurostat, në Europë, Sllovakia dhe Portugalia kanë detyrimet më të mëdha potenciale që lidhen me Partneritetet Publik-Privat jashtë bilancit, përkatësisht në 2.9 dhe 2.7% e PBB-së.

### BORXHI

Në Shqipëri, vlera e kontratave PPP tashmë aktive që financohen nga buxheti dhe nuk janë përfshirë në borxh është 1.9 miliardë lekë, ose 15% e PBB-së, sipas të dhënave të Fondit Monetar Ndërkombëtarë në rishikimin e marrëveshjes së fundit me Shqipërinë (shtator 2018), të publikuar dje. Në të gjitha shtetet anëtare të BE-së, detyrimet që lidhen me Partneritetet Publik-Privat (PPP) janë në 3% të PBB-së, teksa në Shqipëri është 5 herë më i lartë, 15%. Pas Sllovakisë dhe Portugalisë, vlerën më të lartë të PPP-ve jashtë bilancit e ka Portugalia (2.7%), Hungaria (1.5%) dhe Mbretëria e Bashkuar (1.4%). Për vitin 2017, dhjetë vende nuk raportuan asnjë detyrim lidhur me PPP jashtë bilancit, të tilla si Holanda, Bullgari, Çekia, Gjermania, Franca, Luksemburgu, Polonia, Rumania, Sllovenia



### REZIQET

Eurostat publikoi dje listën e vendeve të BE-së sipas detyrimeve potenciale jashtë bilancit për kontratat me Partneritet Publik Privat në raport me PBB. Vlerat përfaqësojnë shumën e financimeve që do të financojë buxheti i këtyre vendeve për kontratat PPP dhe që nuk janë llogaritur në borxh.

dhe Suedia. Në shumë vende të BE-së, PPP-të jashtë bilancit janë vërejtur në qeverinë qendrore, ndërsa në disa nga qeverisja lokale.

### FMN

Në një deklaratë të këtyre ditëve, FMN vuri në dukje se rritja e shpejtë e PPP-ve ka shtuar edhe risqet fiskale dhe stafi propozoi hapa të mëtejshëm për të

kontrolluar këtë aspekt. Përveç stokut ekzistues të PPP-ve prej 31% e GDP-së (që mbulon më shumë se 220 projekte, përfshirë koncesionet në energji me më shumë se 23 pikë përçindje) në buxhetin e 2019-ës, dokumentet parashikojnë një listë të PPP-ve potenciale që arrijnë në 15% të GDP-së", thuhet në raport.

**Tirana International Airport**  
Nënë Tereza

### TENDER NOTIFICATION

**SUPPLY WITH FUEL FOR AIRSIDE VEHICLES FUEL STATION  
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for supply with fuel for airside vehicles, fuel station, for a period of two year with possibility of renewal.

The company needs to have the respective license for fuel supply, and also be equipped with it's own tanker, that will deliver the fuel to Tirana International Airport fuel station.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: [apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com); [fvojka@tirana-airport.com](mailto:fvojka@tirana-airport.com); [ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com) specifying request for information for "Supply with Fuel for Airside Vehicles Fuel Station".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'SUPPLY WITH FUEL FOR AIRSIDE VEHICLES FUEL STATION FOR TIRANA INTERNATIONALAIRPORT'.

The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k**  
Procurement Department  
Administration Building  
Rinas, Tirana  
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs on 7 February 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all the following addresses:  
[apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com)  
[fvojka@tirana-airport.com](mailto:fvojka@tirana-airport.com)  
[ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com)

Dekani i FDUT: Mësimi do të vijojë normalisht në ambientet e gjimnazit edhe në fundjavë

# Ministrja e Arsimit: Nuk e shohim me rëndësi ndryshimin e ligjit për arsimin e lartë

## Studentët bojkotues të Drejtësisë i vënë drynin "Petro Nini"

Ditën e djeshme, pas plotësimit të kërkesës së tyre, studentët e fakultetit të Drejtësisë në UT u grumbulluan para gjimnazit "Petro Nini Luarasi" për të zhvilluar mësim. Por studentët që ende vazhdojnë bojkotin deri në plotësimin e kërkesave, kanë shkuar te godina e gjimnazit dhe kanë mbyllur derën me zinxhirë në mënyrë që studentët e tjerë mos futen në mësim. Përballë kësaj situatë, studentët që kërkojnë të zhvillohet mësim për të mos humbur vitin akademik janë futur përmes një dore tjetër të gjimnazit. I pranishëm në ambientet e gjimnazit "Petro Nini Luarasi", ka qenë edhe dekani i Fakultetit Juridik Artan Hoxha, i cili disa ditë më parë, nëpërmjet një shkresë drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kërkoi ambiente të reja për zhvillimin e leksioneve për studentët që dëshirojnë t'i ndjekin. "Do të zhvillohet mësim çdo pasdite tek gjimnazi 'Petro Nini Luarasi'". Do këtë mësim dhe të shtunë edhe të diel. Jemi të detyruar për këtë zgjidhje", ka thënë dekani i Juridikut, Artan Hoxha në fjalën e tij para studentëve. Kërkesa e dekanit erdhi pasi një pjesë e studentëve vijnë ngulimin në ambientet e këtij fakulteti në shenjë proteste për plotësimin e kërkesave të tyre dhe nuk lejohen pjesën tjetër të zhvillojë procesin mësimor në audi-



Kyca e derës së gjimnazit nga studentët bojkotues



Bojkoti në Fakultetin e Shkencave Sociale

to. **REAGIMI I MINISTRES**  
Ministrja e Arsimit Besa Shahini u shpreh kundër amendamenteve të LSI-së për ligjin e arsimit të lartë, duke shpjeguar arsyet përse kërkesat janë të paealizueshme. E ftuar në komisionin e Edukimit, Shahini tha se shumë shpejt do të jetë aktiv portali i transparencës, ku buxheti dhe çdo vendim i senatëve akademikë të universiteteve do të bëhet publik. Kryetarja e komisionit, Al-

bana Vokshi akuzoi ministrin se ka mashtruar studentët me paktin për universitetin. "Ka të bëjmë me një nismë ligjore për ndryshimin e katër neneve të ndryshimit të ligjit të arsimit të lartë. Krijta e përfaqësues së studentëve nga 10-50 për qind, por edhe në organet e tjera të zgjedhjeve të dekanëve, por edhe në borde të tjera të menaxhimit. Vendimet në senat duhet nga persona me një ekspertizë shumë e lartë. Ne për hir të transparencës dhe llog-

aridhënies kemi marrë një vendim që do të shkarkojmë të gjithë drejtuesit e bordeve, ndërsa kemi bërë thirrjen publike për përfaqësues të rinj. Kemi themeluar portalin e transparencës. Aty do të botohen të gjitha vendimet dhe të gjitha buxhetet. Ky informacion do të azhurnohet çdo tre apo katër muaj dhe kjo do shtojë transparencën", tha mes tjerash ministrja Shahini. Kjo e fundit shtoi se ndryshimet e VKM-ve nuk janë të rëndësishme. "Nuk i shohim të domosdoshme që këto ndryshime të adresohen si ndryshime ligjore, ne me VKM dy nga çështjet e studentëve i kemi adresuar tashmë", - tha Shahini, e cila duke vijuar më tej shtoi se studentët duan rritjen në 50% të numrit të studentit në senat, ndërkohë që kjo nuk është e mundur pasi pjesëmarrja në senat kërkon gradë dhe nuk është një praktikë që ndiqet as në vende të tjera.

**BOJKOTI**  
Në rrethet e studentëve të Fakultetit të Histori-Filologjisë dhe Shkencat Sociale vazhdojnë bojkotin e mësimi. Ata shprehën të vendosur dhe theksojnë se nuk do të tërhiqen deri në plotësimin e kërkesave të tyre. "Bojkoti po vazhdon dhe jemi ende në këmbë. Do ta mbajmë dhe këtë javë deri sa javën tjetër presim dhe mbështetjen masive të pedagogëve që i kanë lënë afat deri në datën 1 shkurt qeverisë", shprehet një studente e Fakultetit të Shkencave Sociale.

**BESA SHAHINI**  
Ministrja e Arsimit, Besa Shahini u shpreh kundër amendamenteve të LSI-së për ligjin e arsimit të lartë, duke shpjeguar arsyet përse kërkesat janë të paealizueshme. E ftuar në Komisionin e Edukimit, Shahini tha se shumë shpejt do të jetë aktiv portali i transparencës, ku buxheti dhe çdo vendim i senatëve akademikë të universiteteve do të bëhet publik.

## "Jashtë keqberësit nga mjediset universitare"

### Studentët konfliktohen me kryebashkiakun Veliaj: Ti vrave Ardit Gjoklajn

#### AKTIVISTET

Jo vetëm denonuan gënjeshttrat e Veliajt për rregullimet e godinave, por edhe i kujtuan se është përgjegjësi kryesor për vrasjen e punëtorit 17-vjeçar Ardit Gjoklajn. Arditi kishte ëndërr të vazhdonte studimet universitare, por grykësia e Veliajt dhe pronarit të firmës së plehrave i morën jetën", - shkruan lëvizja "Për Universitetin".

edhe i kujtuan se është përgjegjësi kryesor për vrasjen e punëtorit 17-vjeçar Ardit Gjoklajn. Arditi kishte ëndërr të vazhdonte studimet universitare, por grykësia e Veliajt dhe pronarit të firmës së plehrave i morën jetën", - shkruan lëvizja "Për Universitetin". Menjëherë pas konfliktimit me studentet, shoqëruesit e kryebashkiakut kanë nxjerrë jashtë dy studentet. "Të bezzisur nga e vërteta, shoqëruesit e Veliajt dërhynë me forcë, tentuan t'u merrnin celularët dhe në fund i nxorën jashtë studentet nga godina e mjerueshme ku ato banojnë. Jashtë keqberësit



Veliaj gjatë debatit me studentët

nga mjediset universitare! Drejtësi për Ardit Gjoklajn! Studentët e bashkuar kanë

për të fituar!,-theksojnë më tej aktivistët e lëvizjes "Për Universitetin".

Kryebashkiaku i Tiranës ka zhvilluar dje një takim me studentët që banojnë në godinat e Qytetit Studenti. Por studentët dhe aktivistët e lëvizjes "Për Universitetin", Arbjo Çibuku dhe Evelina Dëma u ngritën në këmbë dhe hodhën akuzat ndaj kreut të Bashkisë së Tiranës. "Erion Veliaj nisi një takim fasadë në godinat 26-27 të Qytetit Studenti. Studentët dhe aktivistët e Lëvizjes Për Universitetin, Arbjo Çibuku dhe Evelina Dëma, u ngritën në këmbë dhe jo vetëm denonuan gënjeshttrat e Veliajt për rregullimet e godinave, por





Voltiza Duro



Diskutimi mbi konsumatorin në Universitetin "Luarasi"



Ethem Ruka: Ka ende shumë punë për t'u bërë. Dekania: Ankesa nga qytetarët

# "Luarasi", diskutim për mbrojtjen e konsumatorit me aktorët më të rëndësishëm të fushës

Kreu i AK publikon 6 tregjet nën hetim, ndër to mielli e nafta

Mbrojtja e konsumatorit dhe të drejtat e tij vazhdojnë të mbeten një çështje sensitive në vendin tonë. Në kuadër të problematikave që hasin qytetarët, stafi akademik i universitetit "Luarasi" ka organizuar një tryezë të rrumbullakët me temë: "Të drejtat e konsumatorit, garancitë dhe mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave". Të pranishëm në diskutim ishin edhe përfaqësues nga Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Agjensia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Avokati i Popullit e Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Rekori i "Luarasit", prof. dr Ethem Ruka tha në fjalën e tij se pas tranzicionit, Shqipëria është përpjekur të adaptohet me standartet evropiane lidhur me mbrojtjen e konsumatorit. Ai më tej theksoi se ka ende shumë gjëra për t'u rregulluar praktikisht në këtë fushë. "Jemi mbledhur për një çështje shumë të rëndësishme që ka të bëjë me mbrojtjen e konsumatorit. Është dicka shumë sensitive, e rëndësishme. Gjithë filozofia jonë në këto vite ka qenë të adoptojmë standartet për mbrojtjen e konsumatorit në të gjithë hapësirën evropiane dhe në vendet e tjera të zhvilluara. Por midis asaj që shkruhet, legjislacionit dhe asaj që bëhet ka një distancë shumë të madhe. Ka gjithmonë gjëra për t'u rregulluar", tha Ruka.

**HETIMET NGA AK**

Autoriteti i Konkurrencës ka marrë nën hetim tregun agro-ushqimor përcimim abuzive; tregun e shërbimeve bankare; tregun e prodhimit dhe tregimit të naftës bruto, si dhe tregun e importit e prodhimit të miellit. Këto hetime mbi tregjet u diskutuan gjatë tryezës së rrumbullakët në "Luarasi" nga kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës, prof. dr. Juliana Latifi. "Një treg tjetër që ne morëm këtë vit në shqyrtim dhe është me shumë interes është tregu agrorushqimor. Të gjithë në përballemi me çmime relativisht të larta.



Kreu i AK-së, Juliana Latifi



Gjatë bashkëbisedimit në "Luarasi"

ana Latifi. "Një treg tjetër që ne morëm këtë vit në shqyrtim dhe është me shumë interes është tregu agrorushqimor. Të gjithë në përballemi me çmime relativisht të larta. Kompania, e cila operon në tregun agrorushqimor abuzon me çmimet. Kërkuam hapje hetimi paraprak me një masë të përkohshme dhe në fund një gjobë. Një tjetër treg që kemi futur në proces hetimi është dhe tregu i shërbimeve bankare. Në procedurë hetimore kemi marrë edhe tregun e importit, prodhimit dhe tregimit e miellit, të naftës bruto në të cilat tregtarët abuzojnë me çmimet", theksoi kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës. Latifi shtoi se kanë nisur hetimet edhe mbi tregun e

shërbimit spitalor dhe atë të arsimit të lartë në vend. "Kemi hapur hetime dhe jemi akoma në procedurë për tregun e shërbimit spitalor dhe një hetim të përgjithshëm në tregun e arsimit të lartë", tha Latifi.

**SHEMBUJT KONKRETË**

Më tej, Anisa Buzheli nga Autoriteti i Konkurrencës ka demonstruar me shembuj konkretë masat e marra nga institucioni në rastet e konstatimit të shkeljeve të të drejtave të konsumatorit. "Komisioni i konkurrencës i ka dhënë disa rekomandime Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë", tha Buzheli. Dekania e Fakultetit të Drejtësisë në "Luarasi", Rezana Konomi ka bërë me dije se në zyrën ligjore që oper-

on falas nga ky universitet, kanë ardhë ankesa të shumta nga qytetarët lidhur me cënimin e të drejtave të konsumatorit. "Konstatuam që ankesat që vinin ishin pa dyshim të shumta, por nga mbrojtja e të drejtës konsumatore nuk është bërë as sa duhet në zbatimin e këtij kuadri ligjor. A ka mundësi që ky zë që më së shumti është i padëgjuar, si zë, konsumatori, të mund të dëgjohej më shumë? Është shumë e rëndësishme të mund të informojmë shtresa, të cilat janë në kushte më të pafavorshme dhe që cenohen më lehtë nga shkelja që u bëhet të drejtave të tyre. Në fund të fundit, tryeza të tilla në audite universiteti këtë kanë për qëllim: të zhvishemi nga politikëbërja dhe të themi atë që duhet në nivel eksperti dhe profesionalist", u shpreh Konomi. Edhe përgjegjësja e Sektorit Juridik në AKU, Arsiola Dyrmishi ka pohuar se ka pasur një rritje të numrit të ankesave të qytetarëve që denoncojnë subjekte të ndryshme për shkelje ligjore. "Ka pasur një numër të lartë të ankesave të konsumatorëve duke nisur nga fakti që kanë treguar më shumë besim ndaj asaj që autoriteti kombëtar i ushqimit ka bërë, por që është e kuptueshme që duhet edhe më shumë për sigurinë ushqimorë", tha Dyrmishi. Nëpërmjet kësaj tryeze, "Luarasi" sollti një diskutim të hapur për gjithë aktorët që luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit shqiptar.

**Gjermania, dritë jeshilë në pranimin e Maqedonisë në NATO**

**Zimbërt: Kusht për anëtarësim, t'u jepet fund debateve për emrin e vendit me Greqinë**

Në takimin e djeshëm, qeveria gjermane dha një dritë jeshilë për nënshkrimin e protokollit të pranimit të Maqedonisë në NATO. Duke njoftuar vendimin këtë pasdite në Berlin, zëdhënësi i qeverisë Stiven Zimbërt tha: "Ky është një lajm i mirë për Evropën. Ne besojmë se përfshirja e Maqedonisë Veriore do të kontribuojë jo vetëm për sigurinë dhe stabilitetin e Aleancës Euroatlantike por do t'i japë një shtysë të mëtejshme për stabilizimin e Ballkanit Perëndimor".

Në shpjegimin e vendimit gjerman Stephen Zaimpert vuri në dukje se një parakusht për anëtarësim në NATO ishte për t'i dhënë fund mosmarrëveshjes për



emrin e vendit me Greqinë. Kjo u arrit me ratifikimin e Marrëveshjes së Prespës nga parlamentet e të dy vendeve. Është një "marrëveshje historike me të cilën shkroi Shkupin dhe Athinën his-

torinë", tha Zimbërt.

**PYETJET PËR ANËTARËSIMIN NË BE**

Siç e informoi me pas, nënshkrimi i protokollit të pranimit do të mbahet në

Bruksel në shkurt nga përfaqësuesit e përhershëm të vendeve anëtare të NATO-s. Prej këtij momenti, Shkupi do të fitojë statusin e vëzhguesit. Hyrja e vendit do të hyjë në fuqi pas ratifikimit të protokollit nga të gjithë anëtarët e NATO-s. Procesi i ratifikimit në Gjermani parashikon dorëzimin e një ligji në parlament. Z. Weber siguroi se qeveria gjermane do të kërkojë që ligji të votohet "se shpejti" nga parlamenti. Për sa i përket perspektivës Europiane të vendit fqinj Stephen Zaimpert ka deklaruar se edhe për këtë vend dhe për të gjitha vendet e tjera të Ballkanit

Perëndimor të zbatojë "premtimin" e Këshillit Evropian që të mund të bashkohet me BE në qoftë se ata i përmbushin të gjitha kriteret. "Së shpejti" në qershor 2019, Këshilli Evropian do të vendosë nëse do të hapë negociatat e pranimit me Shkupin. Një parakusht për një vendim pozitiv është nëse për të krijuar "progres të duhur" për "reforma të qëndrueshme, për shembull në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar", tha Zaimpert. Në të njëjtën qëndrim zëdhënësi i Departamentit ka shprehur pikëpamjen se Marrëveshja Prespa "pa paragrykim" për pozicionin që do të mbajë Greqinë në të ardhmen në lidhje me kushtet që vendi fqinj duhet të përmbushë për t'u bashkuar me BE-në.

Zaev: Bashkësive etnike iu mundësohet e drejta e përdorimit të gjuhës së tyre

**Maqedoni, ministrat flasin shqip në mbledhjen e qeverisë**

*Nis ndërrimi i tabelave me emrin e ri shqiptar*

Polemika e parë, pas fillimit të zbatimit të dy gjuhësisë, ishte kur ministri i Arsimit, Arbër Ademi nuk mbeti indiferent ndaj kërkesës së një kryetari të Komunës së Velesit, që pyetjeve t'u përgjigjet edhe në gjuhën maqedonase. Ministri tha se do të përgjigjet shqip, ashtu siç është parashtruar pyetja. Por, deputeti i opozitës, Vlatko Gjorçev, njëherazi i vetmi që ka shpallur kandidaturën për zgjedhjet presidenciale nga Kuvendi i Maqedonisë, i bëri thirrje qeverisë, që të mos i hedhin tabelat ku shkruan emri Republika e Maqedonisë, për shkak se, siç tha, pas disa viteve mund sërish të hyjnë në punë. "Ndoshta për dhjetë, pesëmbëdhjetë vite do të vijë koha kur ne apo pasardhësit tanë do të duhet ta fshijmë pluhurin nga ato tabela dhe ndoshta sërish do ta shohin dritën". Por ndryshe mendojnë socialdemokratët. Gjuha shërben për t'u kuptuar mes njëri-tjetrit, politikanët mos të bëjnë ndarje, thonë nga kjo parti. "Çdokush ka të drejtë të flasë në gjuhën e tij amtare. Ka kaluar koha që për këto tema dikush të rreh në gjoks, të luajë rolin e patriotit dhe të përfitojë politikisht". Ndërkaq nga qeveria e Maqedonisë zyrtarisht bënë të ditur se ka filluar aplikimi i dy gjuhësisë edhe në seancat qeveritare, ku ministrat shqiptarë kanë folur dhe debatuar në gjuhën shqipe. Ndërkaq ministrat e qeverisë së Maqedonisë prej dje kanë filluar të aplikojnë përdorimin e gjuhës shqipe në mbledhjet e qeverisë. Lajmi e ka bërë të ditur ministri Edmond Ademi, përmes profilit të tij në "Fa-



cebook', i cili ka folur i pari në gjuhën e tij amtare, njoftoi INA. "Pata nderin si ministër i parë shqiptar nga radhët e Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë, që në mbledhjen e sotshme të 117 të qeverisë, të flas në gjuhën shqipe. Ligji për gjuhët, si ligj duhet të rrisë kohezionin mes qytetarëve të etnive të ndryshme, në ndërtimin e një shoqërie për të gjithë, si koncept politik i kësaj qeverie udhëhequr nga LSDM. Para së gjithash ky ligj është në interes të qytetarëve, gjithë bashkësive etnike dhe komunikit të tyre me institucionet, dhe ne si politikan përmes shembullit personal të tregojmë për-

forcimin e këtij kohezioni, duke ju shmangur politikave ditore", shkruan Edmond Ademi, ministër i Diasporës. Ndërkaq, pas botimit të "ligjit të gjuhëve" në Fletoren Zyrtare, në qeverinë maqedonase është folur për herë të parë shqip. Ministrat shqiptarë kanë nisur të përdorin zyrtarisht gjuhën shqipe, si në seancat parlamentare, por edhe mbledhjen e kabinetit. Qeveria maqedonase i ka nisur praktikisht procedurat për fillimin e zbatimit në praktikë të ligjit për përdorimin e gjuhëve, përkatësisht shqipes. Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev ka theksuar se, përmes një hapi të tillë

edhe në praktikë, bashkësive etnike iu mundësohet e drejta e përdorimit të gjuhës së tyre. Qeveria ka marrë, gjithashtu, vendim për fillimin e procedurës së zbatimit në praktikë të emrit të ri të shtetit, "Republika e Maqedonisë së Veriut". Në të gjitha institucionet e nivelit qendror, si në objektin e qeverisë, të ministrave, Kuvendit, vendkalimet kufitare e organe të tjera, tabelat do të duhet të zëvendësohen me emrin e ri të shtetit, ndërsa një lëvizje e tillë do t'u rekomandohet edhe institucioneve të pushtetit lokal. Tabelat do të jenë edhe në gjuhën shqipe, ashtu siç është rregulluar me ligj.

**SHKURT**

**Kuvendi i Maqedonisë i ndërpret rogen e deputetit Gruevskit**

Kuvendi i Maqedonisë ka votuar për propozimit për ndryshimit të ligjit për pagat e deputetëve, me të cilin edhe deputetit në arrati, Nikolla Gruevskit i ndërpritet rroga prej deputeti. Gjatë votimit kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferri ka votuar "i përmbajtur". Ai tha se nuk është i bindur nëse "propozim ndryshimi i ligjit është kushtetues". Gjatë debatit, LSDM dhe VMRO përplasën argumentet e tyre për faktin se është në kundërshtim me Kushtetutën ose jo propozim ligji në fjalë. Ligji kaloi me procedurë të përshpejtuar.

**Kosova në grevë, Haradinaj emëron zv.ministrin e punës**

Qeveria e Kosovës si rrallëherë është në gjendje kolapsi pasi ende nuk është votuar buxheti për këtë vit. Por, pavarësisht kësaj, Haradinaj ka emëruar edhe një zëvendësministër në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Këtë e ka bërë të ditur avokati Besnik Berisha, i cili ka thënë se nuk është ai që është emëruar në këtë pozitë. "Edhe një konsumues buxheti, ama be po ju bëj që s'jam unë, se goxha shumë pyetje mora deri me tani. Inshalla po ngopemi me zëvendësministra, e po i heqim krejt ministrat", ka shkruar avokati Berisha. Numri i zëvendësministrave në Qeverinë Haradinaj është afro 80.

**Shpërthen epidemia në Mal të Zi, 5 të vdekur nga gripi**

Pesë persona kanë vdekur nga gripi gjatë javës së kaluar në Malin e Zi, ka njoftuar Instituti i Shëndetit Publik. Në mesin e të vdekurve është edhe një fëmijë dyvjeçar. Përveç një gruaje, për të cilën dihet se ishte e vaksinuara, të tjerët nuk kanë qenë të vaksinuara kundër gripit sezonal, thuhet në deklaratë. Raportohet se 386 persona me simptoma të ngjashme të gripit janë paraqitur në qendrat spitalore, që është dy herë më shumë se një javë më parë dhe tre herë më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. "Pritet që epidemia do të kulmojë në javë të ardhshme, pas së cilës numri i pacientëve gradualisht do të zvogëlohet", thuhet në deklaratë. Shumica e pacientëve janë të moshës 20-64 vjeç, rreth 60 për qind, ndërsa numri i fëmijëve të sëmurë është vazhdimisht në rritje, raporton agjencia Beta.

**Haradinaj, letër kryeministrave të botës, reagon Serbia**

Pas letrës që Haradinaj i ka dërguar kryeministrave në të gjithë botën ka reaguar Serbia me anë të ministrit të Jashtëm, Ivica Daçiç. Daçiç ka thënë se kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj nuk është i vetëdijshëm për situatën në të cilën gjendet. "Nëse është ashtu, pse nuk bëhen anëtarë në Kombet e Bashkuara, INTERPOL ose UNESCO? Pse 13 shtete i kanë tërhequr njohjet dhe pse tani SHBA dhe BE pranojnë që të kërkojnë një kompromis?", deklaroi Daçiç për "Veçerjen Novosti". Haradinaj në letrën e tij kishte shkruar se statusi i Kosovës është konfirmuar më 17 shkurt të vitit 2008 me shpalljen e pavarësisë dhe se dialogu me Serbinë ka për qëllim normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë me njohje të ndërsjella dhe se Kosova bisedon me Serbinë si shtet sovran.



## Sulm me armë në Francë, 1 i vdekur e 6 të plagosur

### I moshuari 70-vjeçar qëllon me snajper në Korsikë, izolohet me dy pengje në shtëpinë e tij

Një burrë 70 vjeç hapi zjarr në mes të një rruge në Bastia, Korsikë pasditen e sotme dhe më pas u fsheh pas 2 pengjeve. Gjashtë persona u plagosën, ndërsa një mbeti i vrarë, siç kanë raportuar autoritetet lokale. Autori u mbyll më pas në shtëpinë e tij. Policia është duke zhvilluar një operacion për kapjen e autorit. Të shtënat me armë ndodhën në lagjen e Montosoro. Një përfaqësues i prefekturës tha se ishte "një individ i armatosur". Prokurori Karolin Tarou, i cili ishte në vend, tha se një nga të plago-



surit është në situatë serioze. Ndër viktimat është një polic, i cili është transferuar në një spital. Nuk dihen motivet që e shtynë autorin të kryente një sulm të tillë. Sipas mediave franceze, 3 persona janë dërguar në spital në gjendje të rëndë, pasi një burrë rreth 70 vjeç, hapi zjarr. Gjithashtu, sipas Le Parisien mësohet se mes të plagosurve është dhe një polic, i cili ka marrë plagë në qafë. Njësitë e policisë dhe xhandarmëria janë në vendngjarje për të bërë të

mundur arrestimin e personit që hapi zjarrin. Deri më tani nuk dihen arsyet e ngjarjes. Zona është rrethuar dhe autoritetet vendase apelojnë që të shmanget kalimi në zonën ku ndodhi ngjarja. Ngjarja ka ndodhur në qytetin e Bastias rreth orës 16:30 të ditës së djeshme. Lajmin e bëjnë të ditur mediat lokale franceze, të cilat shkruajnë se i moshuari ka gjuajtur me snajper edhe pse dyshimet e para nuk janë për një akt terrorist. Mësohet se policia ka lokalizuar të moshuarin, i cili fshihet brenda shtëpisë së tij, por policia dyshon se pas atentateve ai ka marrë dhe dy pengje me vete në banesën e tij.

## SHKURT

### "Transparency International": Shtetet më të korruptuara në botë

Somalia është vendi më i korruptuar i botës, sipas Transparency International, ndërsa Danimarka kryeson listën e shteteve ku korruptsioni është në nivel të ulët. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për herë të parë që nga viti 2011, janë larguar nga lista e 20 shteteve me korruptsion më të ulët. SHBA ka humbur 4 pikë, sipas renditjes së TI. Ndërsa Hungaria është vlerësuar më shumë si regjim autokratik. Estonia, Bregu i Fildishtë, Senegali dhe Guajana kanë shënuar përmirësime. Pas Somalisë që është vlerësuar si shteti më i korruptuar, renditen Siria, Sudani Jugor, Jemeni, Korea e Veriut, Sudani, Guinea Ekuatoriale, Afganistani dhe Libia. Kurse, kryesimin e vendeve më pak të korruptuara e mbajnë Danimarka, Zelanda e Re, Finlanda, Singapori, Suedia dhe Zvicra. Nuk mbeten pas as Norvegjia, Holanda, Kanadaja, Luksemburgu, Gjermania dhe Britania e Madhe. Në listën me 180 shtete, Shqipëria renditet në vendin e 99-të me 38 pikë, ndërsa Kosova në vendin e 93-të me 37 pikë. Transparency International, duke komentuar këtë listë të publikuar prej saj, tha se korruptsioni ka më shumë shanse të lulëzojë në ato vende ku sistemi demokratik është i dobët.

Ish-kreu i shtetit: Nëse diçka më ndodh mua, SHBA dhe Kolumbia janë përgjegjëse

# Venezuelë, "izolohet" presidenti i vetëshpallur Guaido

Maduro pretendon se Trump urdhëroi ekzekutimin e tij

Pasi u vetëshpall presi dent i Venezuelës, Juan Guaidos i janë bllokuar të gjitha asetet në pronësi dhe i është ndaluar të dalë jashtë vendit. Prokurori i Përgjithshëm nisi hetimet ndaj liderit të opozitës, për cenim të paqes me nxitjen e protestave të dhunshme kundër presidentit majtist, Nikolas Maduro. Për Guaidon, ky ishte një vendim i pritshëm. "Nuk po e nënvlerësoj rrezikun se mund të burgosem. Për fat të keq ky është një regjim që nuk ofron asgjë të re për popullin venezuelian". Xhon Bolton, Këshilltari për Sigurinë i Presidentit Trump, paralajmëroi përmes Twitter-it se çdo kërcënim ndaj Guaidos do të pasohet me kundërpërgjigje të ashpër nga Shtetet e Bashkuara. Masat ndaj Presidentit të vetëshpallur shihen si një përpjekje e Nikolas Maduros për të penguar çdo plan të Washingtonit që synon lidhjen e marrëveshjeve tregtare me autoritetet provizore të drejtuara nga Guaido. Udhëheqësi majtist tentoi ta paralajmëronte kreun e Shtëpisë së Bardhë se duhet t'i mbante larg duart nga Venezuela, edhe pse me një anglishte që lë për të dëshiruar. Mbështetjen për Maduron e rikonfirmoi ministri i Jashtëm rus Sergei Lavrov, i cili e quajti të jashtëligjshme ndërhyrjen amerikane në punët e brendshme të Venezuelës. Ndërkaq regjimi i presidentit venezuelas, Nicolas Maduro rriti dje presionin kundër rivalit të tij, Juan Guaido pasi SHBA-ja i dha presidentit të vetëshpallur të përkohshëm kontrollin mbi disa llogari të rëndësishme bankare dhe prona. Prokurori i përgjithshëm, Tarek William Saab tha se i ka kërkuar Gjykatës Supreme të ndalojë Guaidon nga largimi nga vendi dhe të ngrijë llogaritë e tij bankare. Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo autorizoi presidentin e përkohshëm të Venezuelës, Juan Guaido që të



Presidenti i vetëshpallur në Venezuelë, Juan Guaido

### NICOLAS MADURO

"Pa dyshim Donald Trump dha urdhër që të më vrisnin. I tha qeverisë kolumbiane, mafias kolumbiane të më vriste mua. Nëse diçka më ndodh mua, Donald Trump dhe presidenti kolumbian, Ivan Duque do të jenë përgjegjës", - tha Maduro për "RIA Novosti".

marrë dhe kontrollojë disa prona në llogari të qeverisë së Venezuelës apo të Bankës Qendrore të Venezuelës që kontrollohen nga Banka e Rezervës Federale të Nju Jorkut apo çdo institucion tjetër bankar amerikan. Nga ana tjetër, presidenti i Venezuelës, Maduro, pretendon se

Donald Trump urdhëroi qeverinë e Kolumbisë dhe mafian ta vriste, edhe pse, në fakt, ai është një mbrojtur nga një kërcënim i tillë. "Pa dyshim, Donald Trump dha urdhër që të më vrisnin, u tha qeverisë kolumbiane, mafias kolumbiane, të më vriste mua, nëse diçka më ndodh

## FRANCË, GJENDEN MBETJET E AEROPLANIT KU UDHËTONTE FUTBOLLISTI



FOTOLAJMI

Ekipet e kërkimit besohet se kanë gjetur mbetje të avionit të vogël që u rrëzua një javë më parë, me të cilin udhëtonte futbollisti Emiliano Sala. Në brigjet veriperëndimore të Francës janë gjetur sedilje të avionit. Lajmi për gjetjen e mbetjeve është bërë i ditur nga Agjencia Britanike e Hetimit të Aksidenteve Ajrore. Avioni i vogël ku udhëtonte futbollisti 28-vjeçar Emiliano Sala u zhdruk nga radarët para një jave.

mua, Donald Trump dhe presidenti kolumbian, Ivan Duque do të jenë përgjegjës", - tha Maduro për RIA Novosti. Maduro, sidogoftë, shprehu besimin në shërbimet e vendit të tij. "Jam gjithmonë i mbrojtur nga njerëzit e Ven-

ezuelës, kemi një shërbim të mirë të inteligjencës", - tha ai. Maduro, gjithashtu, pretendon se Këshilltari i Sigurisë në Shtëpinë e Bardhë, John Bolton ka ndaluar komunikimin me qeverinë e Venezuelës.

### Turqi, dhjetëra pilotë ushtarakë arrestohen për lidhje me Gulenin

Autoritetet turke arrestuan dje disa dhjetëra pilotë të ushtrisë, të dyshuar për lidhje me imamin Fethullah Gulen, i akuzuar nga Ankara për orkestrimin e një grushti shteti në vitin 2016. Sipas prokurorisë së Ankarasë, 48 pilotë të helikopterëve nën komandën e ushtrisë së këmbësorisë, përfshirë tre që kanë gradën e kolonelit dhe katër atë të nënkolonelit, u arrestuan dhe u lanë në paraburgim, në selinë e policisë antiterroriste të kryeqytetit turk. Sipas prokurorisë, prokurori i përgjithshëm i Ankarasë ka lëshuar ndërkohë mandatarreste kundër 15 civilëve të dyshuar si "oficerë të shërbimit të spiunazhit" për llogari të lëvizjes së imanit Gulen që qeveria turke e cilëson "terroriste".

### Sulm me granata në një xhami, 2 të vrarë në Filipine

Dy teologë islamikë janë vrarë dhe katër të tjerë janë plagosur, pas një granate të lëshuar në një xhami në qytetin e Zamboanga, në jug të Filipineve. Edhe të dielën e shkuar një sulm me bomba në një katedrale katolike në Jolo shkaktoi 21 të vrarë. Atentatet e fundit vijnë dy javë pas referendimit që sanksionoi krijimin e një province autonome me shumicë myslimane në jug të vendit.



Organizimet madhështore me rastin e ditëlindjeve

# Festat luksoze të fëmijëve të VIP-ave

Ja detajet nga ditët e gëzueshme

Egla Xhemali

Çdo ditë është ditëlindje kur je e lumtur, megjithatë për VIP-at shqiptarë dhe jo vetëm, dita e lindjes është më e veçanta nga të gjitha. Organizime madhështore, lule, drita, shumë ngjyra e dhurata pafund për të festuar ditën e ardhjes në jetë të fëmijëve të tyre.

Pardje ka pasur festë në shtëpinë e këngëtares, Zaimina Vasjari. Khloe, vajza e saj, festoi ditëlindjen e parë. Me këtë rast i është organizuar një festë madhështore me miqtë dhe familjarët, e me një dekorim mjaft të veçantë, ku mbizotëronte ngjyra e bardhë dhe rozë. Ajo që tërhoqi vëmendjen përveç ambientit të mrekullueshëm ishte dhe veshja e Zaiminës, e njëjtë me atë të vajzës. Vasjari është e martuar me biznesmenin e njohur, Klodian Asllani, i cili ka edhe dy vajza nga martesja e tij e mëparshme.

Ana, vajza e moderatorit të njohur Ardit Gjebrea festoi para pak ditësh 10-vjetorin e lindjes dhe e para që ka zbuluar pak nga festa ka qenë Aurela Gaçe. Videot që publikoi këngëtarja e njohur tregojnë detaje nga mbrëmja speciale për të voglën. Ana ishte qendra e vëmendjes dhe pranë saj ishin shumë miq, moshatarë, por jo vetëm. Në video dukej një ekran i madh në të cilin shfaqeshin imazhe të ndryshme për më të vegjlit, duke i nxitur ata të kërcenin nën ritmet e këngëve. As të rriturit nuk e kanë lënë të kaloj ai moment. Të gjithë i janë bashkuar atmosferës së gëzueshme me rastin e ditëlindjes së Anës. Mes të pranishmëve nuk kanë munguar as personazhe publike, miq të mirë të familjes Gjebrea.

Për ata të dy, 28 nëntori është festë e dyfishtë. Përpos festës së flamurit, Albani dhe Miriami festojnë për të tretin vit ditëlindjen e vogëlushes së tyre Ameli. Nuk do mungonte as këtë herë një festë e organizuar deri në detaje nga dy këngëtarët për Amelinë e vogël. Ishte Albani, ai që na zbuloi një copëz atmosfere të ditës së veçantë, duke ndarë me fansat një foto në "Insta-



gram". "Gëzuar ditëlindjen dashuria ime!

Gëzuar Shqipëri!", - shkuan Albani në krah të fotos, ku shfaqet me Miriamin dhe bukuroshen duke fryrë qirinjtë. Ameli e ve-

shur me fustan kuq e zi duket mjaft e lumtur teksa festonte pranë mamit dhe babit.

Ashtu si për të gjithë prindërit, edhe për mami

Norën dhe babi Robertin, Renee është bekimi më i madh në jetë. Ajo është më e vogla e familjes dhe normalisht që e gjithë vëmendja do jetë e përqendruar tek ajo. Renee festoi në pranverë 3-



vjetorin e lindjes dhe nuk mund të mungonin disa fjalë të dala nga shpirti nga Nora dhe Roberti. Përveç kësaj, ata organizuan edhe një festë për të voglën e tyre. Tema e ditëlindjes vjen nga filmi i


animuar "Frozen", i cili duhet të jetë i preferuari i Renees. E vogla u kënaq nga festa e organizuar posaçërisht për të. Ajo shihej shumë e lumtur duke vrapuar dhe qeshur me shokët e saj.





## Luana do të "zhduket", mësoni çfarë po ndodh me moderatoren

**L**uana Vjollca është një nga moderatore t t më të njohura shqiptare. Përpos moderimit, vitet e fundit Luana i ka hyrë edhe tregut muzikor, ku ka publikuar disa këngë që kanë marrë shumë shikime në "Youtube" dhe janë mirëpritur nga publiku shqiptar. Ajo e ka treguar që është shumë punëtore dhe siç duket, mëngjesi i sotëm e ka gjetur në studio muzikore. Por Luana qenka lodhur aq shumë saqë ka thënë se kur të marrë pushime, do "zhduket" për një muaj. Lajmi i mirë? Moderatorja ka publikuar një mesazh shumë inspirues për fansat e saj femra, të cilave u ka thënë të jenë vetvetja. "Ji femra që do të jesh, jo ajo që presin të tjerët të jesh. Zoti nuk bën gabime. Nëse e sheh me perspektivë, do e shohësh që je një krijesë perfekte e asaj çfarë Zoti ka dashur që ti të jesh. Ji krenare për atë që je. Mbi të gjitha, nuk je një në 1 milion, por një në një jetë të tërë". Dhe sigurisht që nuk mund të mungonin komentet e bukura të fansave të moderatores për këtë mesazh inspirues.



## Almeda në Shqipëri për një arsye të veçantë, pritja e fëmijës e padurueshme

**B**ukuroshja shqiptare duket se është në periudhën e saj më të lumtur dhe po i shijon pa masë ditët e saj si një mama e ardhshme. Së fundmi, Almeda ka ardhur në Shqipëri dhe kjo për një arsye mjaft të veçantë. Janë pikërisht gjyshërit për të cilët Almeda mori avionin dhe u kthye në vendin e saj. Në rrjetin e saj në "Instagram", ajo postoi një foto krahu gjyshit të saj, ku shkruante se ishte rritur pikërisht nga ai dhe kurrësi ai nuk mund ta humbiste shtatzëninë dhe barkun e saj të rrumbullakosur. Në një intervistë për "Telegrafi", Almeda ka rrëfyer se sa më shumë kalojnë ditët, aq më padurim e pret lindjen e djalit të saj dhe këtë që po përjeton si emocionin më të bukur. "Jemi të dy shumë entuziastë. Pritja po bëhet akoma më e padurueshme sado që afrohet momenti. Kam nisur avash-avash të blej disa gjëra të vogla, por e di që rriten shumë shpejt bebet dhe nuk dua ta ekzagjeroj, edhe pse ndonjëherë nuk e mbaj dot veten, sapo shikoj diçka të bukur, dua ta blej. Tani po përjetojmë të dy diçka të re dhe të pakrahueshme me ç'kemi jetuar deri më sot, përpara dhe pas lidhjes sonë, prandaj siç e thash, po mundohemi të dy ta shijojmë në maksimum, madje Tolga ka anuluar dhe shtyrë disa projekte të reja vetëm që të kalojmë bashkë këtë kohë", - ka rrëfyer Almeda.



## U tha se Getoari e la pa punë, zbuloni projektin e Marinës, reperit dhe Flori Mumajesit

**D**arsyeja përse Marina Vjollcën nuk po e shohim më në ekran është bashkeshorti i saj, Getoar Selimi. Reperi u tha se ka disa kushte mjaft diskrete për paraqitjen e Marinës në televizion. Vetëm me produksione serioze dhe veshje të mbuluara, këto janë kushtet e reperit që të thotë "OK" për spektaklet që Marina mund të prezantojë. Sa u përket këtyre thashethemeve apo se kur do ta shohim me ndonjë emision të ri, Marina ka vendosur të qëndrojë e heshur dhe të mos komentojë. Por burime për "iconstyle.al" zbuluan në nëntor të 2018-ës se bashkeshorti i moderatores, Getoar Selimi, do të ishte pjesë e jurisë së spektaklit që pritet të drejtojë Marina dhe shumë shpejt do ta shohim në ekran. Sipas "Anabel", pjesë e këtij projekti do të bëhet edhe Flori Mumajesit, ndërsa programi është ideuar nga Alaudin Hamiti. Gjithashtu sipas medias, titulli pritet të jetë diçka mes "Ti je një yll" ose "E ke një yll". Kjo do të thotë që reperi dhe bashkeshortja e tij kanë rënë dakord me kushtet e vendosura. Tani na ngelet vetëm të presim që ta vërtetojmë me nisjen e emisionit!



## "Nuk mund të mërzitem me ty", Visi i bëri dedikim Lori Hoxhës

**P**rejt disa ditësh përfillet se Lori Hoxha i ka dhënë fund lidhjes 6-vjeçare me bukurshin Vis Bajraktari. Edhe pse asnjë prej tyre nuk e ka konfirmuar këtë lajm, fakti që nuk e ndjekin më njëri-tjetrin në "Instagram" dhe postimet me "kunja" kanë bërë që të shpërthejnë thashethemet. Por edhe pse s'ka pasur reagime nga ata, një veprim i Visit ku fshiu dedikimin romantik që kishte bërë për Lorin i befasoi të gjithë. Visi është shumë aktiv në "Snapchat" dhe një video e postuar së fundmi na tërhoqi vëmendjen. Ai ka publikuar një video teksa ndodhet në makinë e në sfond dëgjohej një pjesë e tekstit të një kënge: "Nuk mund të mërzitem me ty", janë fjalët që dëgjohehen. Mos vallë ishte dedikim për Lorin?





### Programme: Sustainable Development of the Rural Areas

Agriculture and rural development are of crucial importance with regard to socio-economic development in Albania as it accounts for 23% of the GDP and 42% of the overall employment. The majority of agricultural holdings is characterized by fragmented land use and small stock sizes. Significant structural deficits exist as well as weak advisory services and representation structures. In view of the aspired EU accession, a large proportion of farms and smaller processors are not sufficiently competitive. The consolidation of agriculture in the context of EU common agricultural policy and the current situation in rural areas require that the rural population has alternative income and employment opportunities. This is especially true for women and young people. Young people in particular leave the rural regions temporarily or completely in search of more attractive income opportunities. The strongest growth and employment impulses come from rural tourism. The further development of sustainable rural tourism depends heavily on the protection of natural and cultural landscapes and the sustainable exploitation of natural resources in rural areas. The environmental, economic and social potentials in rural areas are not yet sufficiently exploited to sustainably create and sustain diversified income and employment perspectives.

Starting in January 2019, a new BMZ-funded program on rural development will promote income opportunities in rural areas through increased competitiveness and diversification of agriculture, the valorization of biodiversity and the potential of rural tourism for employment-generating activities. The program will contribute to employment promotion in the agricultural sector and non-agricultural activities in rural areas by focusing on the principles and instruments of the EU's common agricultural policy for rural development. It promotes the participation of young people and women and thus contributes to gender equality. The program will apply an integrated approach on rural development with a focus on agriculture and rural tourism. It will consist of three interrelated fields of intervention (outputs):

- Output 1) Policy Advice for Rural Development
- Output 2) Promotion of Selected Value Chains (Cluster I: Tourism; Cluster II: Agriculture)
- Output 3) Improvement of Education & Training in Agriculture & Rural Tourism
- Output 4) Support to Agricultural Knowledge and Innovation System

The programme's duration is foreseen from 01/2019 – 12/2022.

**"Sustainable Development of the Rural Areas" programme, seeks the following staff:  
Advisor – Tourism**

#### A. Responsibilities

The advisor-tourism is responsible for:

- implementing daily operational aspects of all issues related to the project in the following fields:
  - a) policy advice in rural tourism with MoTE (output 1)
  - b) promotion of rural tourism and other value chains related to diversification (output 2)
  - c) identifying and coordinating education and training needs & measures in the field of rural tourism and diversification (output 3)
- support of public and private actors in developing, maintaining and quality assurance of rural tourism infrastructure, destination management products in close coordination with AMA Tourism
- support to planning, coordination and implementation of all activities related to rural tourism
- liaison with MoTE, regional and local tourism structures as well as other donors operating in the field of tourism
- innovation and knowledge management;
- maintaining of a good flow of communication and information between all involved institutions and counterparts and GIZ including regional projects
- ensuring that the contracting and spending of allocated funds run smoothly in his/her area of intervention

The advisor - tourism performs the following tasks:

#### B. Tasks

##### 1. Provision of advisory services

The advisor-tourism

- gives substantial input to development and review of capacity development strategy in his fields of intervention
- establishes and maintains good communication and cooperation with partners on central, regional and local level
- identifies the needs of government institutions, private partners and NGOs as well as the project's beneficiaries
- advises partner institution(s) regarding clarification and identifying needs, developing concepts and strategies, and provides technical input in his field
- participates in identifying needs for external support and advice, drafts terms of reference for local and international consultants, works on policy recommendations and develops a strategic approach
- designs, prepares and conducts project activities and carries out other activities required for implementing outputs 1 and 2 in the field of rural tourism and diversification in close coordination with AMA Tourism and the relevant Albanian partners based on needs
- participates in formulating project activities and helps synchronise the planning and budgeting system and counterparts
- is jointly responsible with the partner institution and AMA Tourism for preparing, implementing and documenting training events, workshops, forums, and other project activities
- monitors the development, implementation and results of activities in his fields of intervention in close consultation with counterparts and AMA Tourism
- support to program monitoring requirements

##### 2. Communication and networking

The advisor-tourism

- develops and maintains contact with all important stakeholders
- provides technical assistance to local and international experts
- ensures knowledge management: collects, processes and distributes relevant information, monitors communication and interaction between government institutions, NGOs and society through analyses of the media, direct dialogue, participation in meetings and seminars etc.

#### C. Required qualifications, competences and experience:

##### Qualifications

- university degree (Master) in social sciences, tourism or regional management
- 5-7 years' professional experience, with at least 3 years' professional experience in tourism projects
- professional knowledge on Destination Management
- professional knowledge on tourism product development
- professional experience in collaboration with public administration at different levels in Albania
- exposure to tourism structures and actors outside Albania
- wide network in the tourism sector in Albania including MoTE and other donors in the field
- overview on agriculture and rural development issues in Albania
- confident and professional appearance towards different hierarchy levels of project partners
- strong organisational competence
- strong desire and ability to work in a team
- willingness to travel (abroad) regularly
- good knowledge and experience in rural areas of Albania (esp. regions of Dibra, Shkoder and / or Vlore)
- very good knowledge of English, ideally a knowledge of German
- willingness to upskill as required by the tasks to be performed – corresponding measures are agreed with management

##### Contract conditions:

- Full time Employment
- Programme office in Tirana
- Assignment period: asap until 31.12.2022

Please forward your application until **17th of February 2019**, to GIZ Office Albania by E-Mail: [giz-albanien-hr@giz.de](mailto:giz-albanien-hr@giz.de) including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

**GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!**

##### Protection of personal data

If processing your expression of interest involves the recording and processing of personal data (such as your name, contact details and address and CV), such data will be processed pursuant to provisions of law no. 9887, dated 10.3.2008 "On protection of personal data", as amended. Your reply to this call and personal data requested are required for the purpose indicated in this vacancy and will be processed solely for that purpose by the programme



### Programme: Sustainable Development of the Rural Areas

Agriculture and rural development are of crucial importance with regard to socio-economic development in Albania as it accounts for 23% of the GDP and 42% of the overall employment. The majority of agricultural holdings is characterized by fragmented land use and small stock sizes. Significant structural deficits exist as well as weak advisory services and representation structures. In view of the aspired EU accession, a large proportion of farms and smaller processors are not sufficiently competitive. The consolidation of agriculture in the context of EU common agricultural policy and the current situation in rural areas require that the rural population has alternative income and employment opportunities. This is especially true for women and young people. Young people in particular leave the rural regions temporarily or completely in search of more attractive income opportunities. The strongest growth and employment impulses come from rural tourism. The further development of sustainable rural tourism depends heavily on the protection of natural and cultural landscapes and the sustainable exploitation of natural resources in rural areas. The environmental, economic and social potentials in rural areas are not yet sufficiently exploited to sustainably create and sustain diversified income and employment perspectives.

Starting in January 2019, a new BMZ-funded program on rural development will promote income opportunities in rural areas through increased competitiveness and diversification of agriculture, the valorization of biodiversity and the potential of rural tourism for employment-generating activities. The program will contribute to employment promotion in the agricultural sector and non-agricultural activities in rural areas by focusing on the principles and instruments of the EU's common agricultural policy for rural development. It promotes the participation of young people and women and thus contributes to gender equality. The program will apply an integrated approach on rural development with a focus on agriculture and rural tourism. It will consist of three interrelated fields of intervention (outputs):

- Output 1) Policy Advice for Rural Development
- Output 2) Promotion of Selected Value Chains (Cluster I: Tourism; Cluster II: Agriculture)
- Output 3) Improvement of Education & Training in Agriculture & Rural Tourism
- Output 4) Support to Agricultural Knowledge and Innovation System

The programme's duration is foreseen from 01/2019 – 12/2022.

**"Sustainable Development of the Rural Areas" programme, seeks the following staff:  
Advisor – Agriculture (2 job positions)**

#### A. Responsibilities

The advisor-agriculture is responsible for:

- implementing daily operational aspects of all issues related to the project in the following fields:
  - a) policy advice in agriculture with MARD (output 1)
  - b) promotion of selected agricultural value chains (output 2)
  - c) identification and coordination of education and training needs and measures in the selected agricultural value chains (output 3)
- strategy and policy advice in agriculture and rural development in the context of EU accession / Common Agricultural Policy for the Ministry of Agriculture
- implementation of agricultural-based value chain activities in rural development
- innovation and knowledge management
- maintaining of a good flow of communication and information between all involved institutions and counterparts and GIZ including regional projects
- ensuring that the contracting and spending of allocated funds run smoothly in his/her area of intervention.

The specific areas of responsibilities will be defined according to the capacities and experiences of both of the selected candidates.

The advisor - agriculture performs the following tasks:

#### B. Tasks

##### 1. Provision of advisory services

The advisor-agriculture

- gives substantial input to development and review of capacity development strategy in his fields of intervention
- establishes and maintains good communication and cooperation with partners on central, regional and local level
- identifies the needs of government institutions, private partners and NGOs as well as the project's beneficiaries
- advises partner institution(s) regarding clarification and identifying needs, developing concepts and strategies, and provides technical input in his field
- participates in identifying needs for external support and advice, drafts terms of reference for local and international consultants, works on policy recommendations and develops a strategic approach
- designs, prepares and conducts project activities and carries out other activities required for implementing outputs 1, 2 and 3 in the field of agriculture in close coordination with AMA Agriculture and the relevant Albanian partners based on needs
- participates in formulating project activities and helps synchronise the planning and budgeting system and counterparts
- is jointly responsible with the partner institution and AMA Agriculture for preparing, implementing and documenting training events, workshops, forums, and other project activities
- monitors the development, implementation and results of activities in his fields of intervention in close consultation with counterparts and AMA Agriculture
- support to program monitoring requirements.

##### 2. Communication and networking

The advisor-agriculture

- develops and maintains contact with all important stakeholders
- provides technical assistance to local and international experts
- ensures knowledge management: collects, processes and distributes relevant information, monitors communication and interaction between government institutions, NGOs and society through analyses of the media, direct dialogue, participation in meetings and seminars etc.

#### C. Required qualifications, competences and experience:

##### Qualifications

- university degree (Master) in agricultural sciences, agronomy, and/or rural development
- 5-7 years' professional experience, with at least 5 years' professional experience in the context of agriculture/rural development (preferably in the context of EU accession)
- good knowledge of the EU Common Agriculture Policy and pre-accession instrument IPARD
- experience in territorial approaches and participatory development
- practical experience and theoretical knowledge of value chain promotion
- confident and professional appearance towards different hierarchy levels of project partners
- strong managerial and organisational competence
- strong desire and ability to work in a team
- willingness to travel (abroad) regularly
- good knowledge and experience in rural areas of Albania
- very good knowledge of English, ideally a knowledge of German
- willingness to upskill as required by the tasks to be performed – corresponding measures are agreed with management
- good working knowledge of ITC technologies (related software, phone, fax, email, the internet) and computer applications (e.g. MS Office).

##### Contract conditions:

- Full time Employment
- Programme office in Tirana
- Assignment period: asap until 31.12.2022

Please forward your application until **17th of February 2019**, to GIZ Office Albania by E-Mail: [giz-albanien-hr@giz.de](mailto:giz-albanien-hr@giz.de) including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

**GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!**

##### Protection of personal data

If processing your expression of interest involves the recording and processing of personal data (such as your name, contact details and address and CV), such data will be processed pursuant to provisions of law no. 9887, dated 10.3.2008 "On protection of personal data", as amended. Your reply to this call and personal data requested are required for the purpose indicated in this vacancy and will be processed solely for that purpose by the programme



REAGIMI



Ecovolis dhe Eko Mëndje në një mision në kujtim të ish burgosurve në kushte çnjerëzore në Spaç



Spaci ka nevojë sot për gjelbërim, për jetë.

# "Mos e prekni Spaçin", shoqatat kundër pishave në ish-burgun famëkeq

Fatmira Nikolli

Në këtë luginë janë varrosur pa lot dhe pa lule qindra të burgosur të konsumuar nga munda dhe dhimbja". Ky është mbishkrimi i pllakatës së vënë në burgun famëkeq të Spaçit, ndaj Spaçi nuk ka nevojë për pisha. Jemi ne që kemi nevojë për Spaçin për të mos harruar!"

Ky është vetëm një prej reagimeve kundër nismës së "Eko mendje" për të mbjellë pisha te burgu i Spaçit.

Përmes një postimi në faqen e tyre në rrjetin social "Facebook", "Eko mendje", një OJF me qëllime ambientaliste e sociale, ka publikuar nismën shoqëruar me një video të rrugës që të çon për në luginën në malet e Mirditës.

Teksti që e shpjegon është si vijon:

"Në Spaç kupton se sa shumë vlen liria dhe sa shumë ia vlen të luftosh për të. 504 pisha për 504 njerëz, të cilëve diktatura iu burgosi trupin, por jo shpirtin. Nëse ende nuk ke qenë në Spaç, ka ardhur dita që ta vizitosh. Të hysh brenda qelive të vogla e të ftohta, të cilat për ironi të ofrojnë një nga peizazhet më të bukura që mund të shohësh syri. Të ndiesh dhimbjen dhe forcën e atyre që lanë jetën aty apo atyre që ia dolën. E kur të shkoni atje, bëni si ne, merrni një pishë me vete apo dy, apo dhjetë. Spaci ka nevojë sot për gjelbërim, për jetë. #vizitospaçin #njëpishëpërspaçin #ecovolis #ekomendje".

REAGIMET

Historiana Eni Papa nuk kundërshtoi ndërhyrjen qoftë edhe me nisma ekologjike, si kjo e mbjelljes se pemëve në Spaç. "Mbajllja e pemëve mund të bëhet poshtë rrugës, por jo lart në Spaç. Ndryshe rrezikohet që ai 'site' memorie të transformohet. Nuk



ka nevojë për t'i dhënë jetë Spaçit, por për ta ruajtur si muze të terrorit komunist. Çdo lloj projekti jo i mirëmenduar dhe jo i mirëdiskutuar do të rrezikojë të ndërshojë fytyrën e terrorit komunist", thotë ajo.

Një ditë pas publikimit të ditës së martë, të mërkurën ka reaguar Instituti për Demokraci, Media & Kulturë (IDMC). Për këtë të fundit, ish-kampi dhe burgu i Spaçit është një vend kujtese për punën e detyruar, vuajtjet, poshtërimin, torturat dhe vrasjet që u bënë kundrejt personave që kaluan dënimin aty nga viti 1968-1990. Instituti shprehet se përkujtimi i viktimave të Spaçit nuk mund të bëhet përmes pyllëzimit të kampsit, por duke ruajtur strukturën e tij të tanishme, duke e kthyer në muze dhe duke treguar historinë e terrorit komunist pikërisht në ato godina dhe atë peizazh autentik që zona ofron. "Autoritetet lokale dhe qendrore

*"Viktimat nuk kujtohen me pyllëzim, struktura të ruhet e paprekur"*



E kur të vish, bëj si ne, merr një pishë me vete apo dhjetë ...

që menaxhojnë objektet muzeale, siç është edhe Spaçi duhet të mbajnë përgjegjësi direkte ligjore për ndërhyrjet dhe dëmet që sh-

kaktohen aty", thekson instituti. Sipas IDMC, të rinjtë dhe gjithë të interesuarit që do ta vizitojnë kampin dhe burgun e Spaçit duhet

ta njohin atë ashtu siç ka qenë, prandaj ai duhet të qëndrojë i paprekur në strukture. "Prej vitesh, të vetmet ndërhyrje të ndërmarra nga aktorë lokalë dhe ndërkombehtarë kanë qenë vetëm në funksion të mirëmbajtjes, të mos rrëzimit të ndërtesës apo të informimit me tabela orientuese. Të mos harrojmë që të burgosurit aty janë përdorur gati si skilevër për punë të detyruar, nxjerrjen e mineraleve në minierën e Spaçit. Ndërhyrja në pyllëzimin e Spaçit e kthen përmbyb këtë tablo, jo vetëm nuk reflekton vuajtjet e tyre, por tallët me historinë duke e kthyer mjedisin në një ambient të gjelbëruar, me ajër të pastër ku vizitorët ftohen të planifikojnë pushimet e radhës. Kampi i Spaçit nuk ka qenë kamp pushimi, por kamp i punës së detyruar. Dhe këtë vend vuajtjeje na takon ta mbrojmë të gjithë!". - thuhet në reagimin e IDMC-së.

Në vijim, instituti thotë se ka mjaft zona të tjera që kanë nevojë t'ju japim jetë duke mbjellë pemë nga organizatat ambientaliste. "Spaci nuk mund t'i japim jetë në këtë formë. Në këtë mënyrë viktimat e Spaçit i vrasim për herë të dytë. Viktimat e Spaçit i respektojmë vetëm duke inkurajuar dhe mbështetur iniciativat për muzealizimin dhe mirëmbajtjen e tij afatgjate, si dhe iniciativat për vizitat studimore me të rinj që Spaçi të mos harrohet", përfundon reagimi.

Burgu dhe kampi i Spaçit është zonë e mbrojtur nga Ministria e Kulturës si vend kujtese. Ligji i ri i trashëgimisë i miratuar më 2018 mbron edhe peizazhin historik të objekteve monument. Nderkaq, prej vitesh qarkullon ideja e një muzeu që do të kujtohet të dënuarit që jetuan e humbën jetën atje. Ai ishte një prej burgjeve ku u dërguan intelektualët e vendit gjatë regjimit komunist.

Opinion i Ditës

# Nxitimi enigmatik i kabinetit të Trump për marrëveshje të rrezikshme Thaçi-Vuçiç

Nga Edmond Krasniqi

(vijnë nga faqja 1)

... për Siguri Kombëtare) John Bolton ndodhet në nguti të çuditshme me presionin për të vazhduar dialogun e rrezikshëm midis Hashim Thaçit dhe Aleksandar Vuçiçit për një marrëveshje në dëm të kufijve të Kosovës.

Pse për këtë administratë në Washington të udhëhequr nga Donald Trump qenka aq në interes të SHBA-ve' heqja e taksës ndaj mallrave të Serbisë dhe të Bosnjës dhe arritja e marrëveshjes midis Serbisë dhe Kosovës?

Dialogu mund të rifillojë edhe me taksën në fuqi, dhe qeveria e Trump mund t'i bëjë presion Serbisë që të heqë dorë nga kushti për taksën.

Por, pse presioni i administratës së Trumpit, përkatësisht i njerëzve si Bolton nuk drejtohet tek Vuçiç, por tek Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj dhe partnerët e tij qeveritarë?

Mos ndoshta Vuçiç është i padëgjueshëm ndaj qeverisë së Trump dhe ai është këmbëngulës në mbrojtjen e interesave ekonomike të Serbisë, sepse e di ligësinë e disa krerëve të institucioneve të Kosovës?!

E kur krerët e Serbisë ngulin këmbë, atëherë presioni bëhet ndaj politikanëve të luhatshëm të Kosovës, në radhë të parë atyre nga PDK, Kadri Veseli dhe Hashim Thaçit, të cilët ndodhen në etet e gjykatës speciale në Hagë për Kosovën.

Është kryeprokurori i ri amerikan Jack Smith ai i cili vendos se kush mund të dërgohet në Hagë për intervistë e të akuzohet për krime lufte.

Kur ka politikanë shqiptarë në Kosovë që ligësohen dhe ndërrojnë qëndrimet sa herë dikush nga perëndimi u ua tregon dhembët, pse jo.

Por, ku do të dërgonte ky lloj dialogu të cilin administrata e Trump e ka marrë kaq me nguti dhe cili do të ishte epilogu i tij?

John Bolton tashmë ka sinjalizuar se për administratën e Trumpit ndryshimi kufijve dhe territorit të Kosovës është i pranueshëm, me arsyetimin se Vuçiç dhe Thaçi po duan kështu.

Qeveria e Trumpit, që nga deklaratat e Boltonit bërë në fund të gushtit në Ukrainë, po e bënë enigmën para publikut ballkanas dhe evropian duke thënë se do të dalë me qëndrim të qartë pasi që të ketë një marrëveshje midis Vuçiçit dhe Thaçit.

Për dallim nga refuzimet e Washingtonit dhe ambasadorëve të saj në Prishtinë dhe Beograd, që pas deklaratës së Boltonit të qartësohen për një marrëveshje eventuale për shkëmbim territore, Gjermania, Britania e



Madhe dhe shumica e vendeve evropiane janë kundër një marrëveshje të këtillë sepse ajo do të sillte konflikte të reja nëpër Ballkan.

Berlini, Londra dhe të tjerët e thonë publikisht dhe vazhdimisht se integriteti territorial i Kosovës është i paprekshëm dhe se marrëveshja nuk bënë në asnjë mënyrë të përfshijë ndryshim kufijsh e territoresh.

Por, pse nuk thotë kështu edhe administrata e Trumpit?

Pse kjo qeveri e tashme në Washington nuk është në të njëjtën vijë me qeveritë e mëparshme amerikane për Kosovën e pavarur dhe territorin e saj?

Pse kjo qeveri në Washington nuk është në të njëjtën vijë me Gjermaninë e Britaninë e Madhe në favor të ruajtjes së territorit të

tashmë të Kosovës së pavarur.

Enigmën duhet qartësuar vet zyrtarët e qeverisë së Trumpit në Washington dhe ambasadorët e saj në Prishtinë dhe Beograd.

Mospajtimet midis fuqive të mëdha për kufijtë aktual të vendeve të Ballkanit nuk premtojnë paqe në Kosovë, Serbi e as rajon të Ballkanit Perëndimor.

Kancelaria gjermane Angela Merkel e ka thënë disa herë qëndrimin e prerë kundër ndryshimit të kufijve të planifikuar nga Vuçiç dhe Thaçi.

Qeveria gjermane dhe ajo britanike kanë vazhduar me këto qëndrime të tyre edhe pas deklaratave të Boltonit dhe enigmës publike të qeverisë së Trump për territorin e tashmë të Kosovës.

Në këto rrethana, deklaratat e Thaçit, Veselit dhe anëtarëve të

LDK-së se duhet hequr taksën për t'u futur në një dialog të këtillë vetëm e vetëm që të mos prishen raportet me siç thonë ata "Amerikën" janë mbulesë e pabazë dhe nuk shkojnë në dëm të integritetit territorial të Kosovës.

Deklaratat e tyre do të kishin kredibilitet vetëm nëse qeveria e Trump do të deklarohej publikisht njëjtë si Gjermania e Britania e Madhe se territori i Kosovës së pavarur është i paprekshëm.

Thaçi, Veseli dhe krerët e LDK-së duhet pyetur dhe kërkua publikisht nga kjo qeveri në SHBA dhe ambasadori në Prishtinë Philip Kosnett që të qartësohen se a është apo nuk është kjo qeveri e tashme amerikane në favor të kufijve të tashmë të Kosovës së pavarur që e kanë ndërtuar dhe njohur qeveritë e mëparshme amerikane.

Kjo nuk vlen për Thaçin, i cili tashmë edhe publikisht i ka thënë qeverisë së Trump se është i gatshëm që me Vuçiçin të bëjë kompromis me territorin e Kosovës.

Dhe përderisa qeveria e Trump po i mbështet Thaçin e Vuçiçin për një kompromis të këtillë, në dëm të integritetit territorial të Kosovës dhe të rrezikshëm për stabilitetin në rajon e krizë të re të mad-

he në derë të Bashkimit Evropian, atëherë Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj dhe të tjerët si ai kanë të drejtë të plotë t'u thonë një 'JO' të madhe kësaj qeverie në Washington edhe për taksën edhe për marrëveshjen e këtillë të dëmshme për Kosovën dhe të rrezikshme për tërë rajonin.

A duhet të ketë Kosova besim ndaj kundërshtarëve të pavarësisë së Kosovës siç ishte dhe është John Bolton?

Ky njeri numër dy në qeverinë e tashme në SHBA, John Boltoni, ishte dhe mbetet kundërshtar i pavarësisë së Kosovës.

Duhet shikuar kjo video dhe lexuar ky shkrim i tij në 2008, pak para se të shpallej pavarësia e Kosovës, për të kuptuar se cila është e vërteta e këtyre njerëzve të Trumpit për pavarësinë e Kosovës.

Në shkrimin në Washington Times të datës 31 janar 2018, Bolton së bashku me Lawrence

Eagleburger dhe Peter Rodman shkruante: "We believe an imposed settlement of the Kosovo question and seeking to partition Serbia's sovereign territory without its consent is not in the interest of the United States".

Në shqip: "Ne besojmë se një zgjidhje e imponuar e çështjes së Kosovës dhe kërkesa për të ndarë territorin sovran të Serbisë pa pajtimin e saj nuk është në interes të Shteteve të Bashkuara (të Amerikës)".

Në letrën publike e ambasadës së Trumpit dhe Boltonit në Kosovë të datës 25 janar thuhet:

"Actions which undermine the Dialogue, disruptions from the sidelines, and refusal to suspend tariffs all run counter to U.S. interests.

Në shqip: "Aksionet, të cilat minojnë Dialogun, ndërprerjet anësore dhe refuzimi për të suspenduar tarifën që të gjitha bien në kundërshtim me interesat e SHBA-ve".

Cili është interesi i kësaj qeverie të Donald Trump dhe njerëzve të saj si Boltoni për një marrëveshje të rrezikshme midis Kosovës dhe Serbisë për të cilën Gjermania dhe Britania e Madhe thonë se nuk guxon që të ndodhë, sepse ajo destabilizon Ballkanin Perëndimor?

Apo kjo qeveri, edhe siç thotë tash, do të deklarohej pasi që Vuçiç dhe Thaçi t'i kenë venë nënshkrimet e tyre në marrëveshjen për shkëmbim territore.

A do të jetë vonë atëherë apo do të ketë kohë ende për shpëtuat konfliktin e ardhshëm në rajon që do të shkaktohej nga marrëveshja e nxitur?

Enigma vazhdon...

(Autori është themelues i agjencionit të lajmeve dtt-net.com për Ballkan Perëndimor - BE dtt-net.com)



Opinioni / i Ditës

# Reagim ndaj letrës së 30 shkrimtarëve dhe publicistëve

Nga Rexhep Qosja

... e nëntë shkrimtarëve e publicistëve të tjerë, mes të cilëve edhe prej pesë fituesve të Çmimit Nobel për letërsi.

Në këtë letër për shumë arsye bëhet thirrje që Bashkimi Evropian të mbrohet, që adhtetarët e këtij Bashkimi ta mbrojnë atë intelektualisht prej shkatërruesve, të cilët gjithnjë e më të zëshëm po shihen e dëgjojnë nëpër disa sheshe e nëpër disa institucione evropiane!

Nuk prisja se kjo letër qëllim-lartë do të më befasonte, siç më befasoi jo vetëm me disa nga mendimet që thuhën në të, po më shumë me disa nga çështjet që në të hesh-ten.

Për këtë arsye, si lexues i veprave e i shkrimeve të disave prej nënshkruesve të kësaj letre, mund të them:

Jam i zhgënjyer.

Jam i zhgënjyer sepse ata e ngri-ritën zërin me shumë vonesë.

Jam i zhgënjyer sepse ata e ngri-ritën zërin vetëm kundër të këqijave që, siç e theksojnë, mund të ndodhin në Evropë pas zgjedhjeve të majit për Parlamentin Evropian në qoftë se fitojnë ata që duan të ringjallin një të kaluar të errët.

Jam i zhgënjyer sepse të këqijat që, thonë, se mund të ndodhin në Evropë pas zgjedhjeve të majit - ksenofobia dhe antisemitizmi po ndodhin tashmë në disa vende të Evropës.


Jam i zhgënjyer sepse i heshtën disa nga të këqijat e tjera që po ndodhin në Evropë dhe tragjeditë që po ndodhin në ujërat jugore të Evropës.

Jam i zhgënjyer sepse nuk e thanë asnjë fjalë keqardhjeje për tragjedinë më të madhe të shekulit në të cilin kemi hyrë: për tragjedinë e viktimitave të luftërave, që në disa vende të Lindjes së Mesme e të Afërme po ndodhin edhe nën patronatin politik e ushtarak evropi-an!

Jam i zhgënjyer sepse me asnjë fjalë keqardhjeje nuk shkruan për rrënimet barbare të tri qytetërimeve të lashta në ato vende të Lindjes së Mesme e të Afërme që po ndodhin edhe nën patronatin politik e ushtarak të disa vendeve të Evropës!

Jam i zhgënjyer sepse asnjë fjalë keqardhjeje nuk u shpreh për islamofobinë që po përshtrihet në Evropë, e nxitur edhe prej terrorizmit - kësaj të keqeje skëterrore, kundërnjerëzore, që po e bëjnë madje edhe në disa vende që u kanë dhënë strehimin, individë dhe grupe të ndryshme me besim islamik duke keqpërdorur islamën për qëllimet e veta politike, ideologjike e të tjera.

Jam i zhgënjyer sepse këta, tridhjetë shkrimtarët e publicistët e shquar, që u paraqitën si ndërgjegje e zgjuar e Evropës së Re, nuk paskan vërejtur se si kolonializmi klasik në disa pjesë të



Afrikës e të Azisë, është zhvilluar tashmë në kolonializëm modern, domethënë në neokolonializëm.

Jam i zhgënjyer sepse kërkesat shtetkrijuese, që u dëgjuan në Barcelonë, i identifikuan me shpërthimet nacionaliste dhe ksenofobe që po dëgjojnë qe sa kohë, sidomos në Budapest, në Varsavë, në Vjenë, në Dresden e ku tjetër.

Jam i zhgënjyer sepse politikë "që nuk e denjëson inteligjencën dhe kulturën" e quajtnë vetëm politikën që do të bëhet në Evropë në qoftë se në zgjedhjet e majit për Parlamentin Evropian fitojnë "shkatërruesit e idesë evropiane" dhe harruan se politikë e tillë po lulëzon tashmë në disa vende të Evropës, sidomos në vendet ish-komuniste qoftë edhe të Bashkimit Evropian!

Jam i zhgënjyer sepse Evropën e quajtnë "të braktisur edhe nga dy aleatë të mëdhenj që në shekullin e kaluar e shpëtuan dy herë

nga vetëvrasja: njëri përtej La Manshit dhe tjetri përtej Atlantikut" dhe, kur shkruan kështu, këta dy aleatë, të përfytyruar gabimisht si kundërshtarë të BE-së, i imagjinuan në të njëjtin kontekst politik me Rusinë e Putinit, e cila e dëshiron rrënimin e këtij Bashkimi të Evropës, duke vepruar ku mundet e si mundet për atë rrënim! Është interesant se në këtë letër nënshkruesit e saj, me dashje a padashje, na e përkujtu- an qëndrimin e krijuar në kohën e Napoleon Bonapartës kur u tha: Anglia është për Evropën çka është Shejtani për njerëzimin!

Jam i zhgënjyer sepse në letrën manifest politik nuk u sqarua se çfarë duhet të jetë Bashkimi Evropian që, besoj, s'do të mund ta plagosin "varrmihësit e idesë evropiane": do të jetë Evropë e pluralizmit kombëtar, kulturor, fetar apo Evropë e totalitarizmit evropianist; do të jetë Evropë e kombeve të barabarta apo Evropë e dy-tre rrrathëve me barazi të ndry-

shme të përbërësve kombëtarë të saj; Evropë, si e thotë evropiani i shumëdëshiruar, Karl Markus Gaus, e shumë gjuhëve apo e Evropë e vetëm disa gjuhëve, që do të na e mësojë barbarinë; Evropë e pastruar prej të gjitha paragjykimëve të së kaluarës apo Evropë në të cilën racizmin e dikurshëm të Lëkurës do ta zëvendësojë racizmi i Kuletës?

Bashkimi Evropian është ideja, është projekti, është ideali më madhështor në historinë e Evropës. Ai është premtimi politik, kulturor, qytetëruar, human, etik, që popujve të Evropës u sjell besimin se kurrë më nuk do të përfytyrojnë luftëra botërore, as luftëra ballkanike, as Kongrese të Berlinit si ai i vitit 1878, as Konferenca të Londrës si ato të viteve 1913 e 1915, as Konferencë të Paqes si ajo e Parisit e vitit 1919, as "rende" të tmerrshme fashiste, staliniste, naziste; është premtim që popujve të Evropës u sjell besimin ndaj li- rive, barazisë së dinjiteteve dhe të mirëqenies së tyre e të pasardhësve të tyre.

Shqiptarët e duan sot Evropën e këtyllë, dhe e duan shumë përkushtueshëm duke u përpjekur që të sjellin vlerat e saj në jetën e tyre dhe duke u përpjekur që të plotësojnë kushtet që Shqipëria e Kosova, siç janë sot apo, edhe më mirë, të bashkuara, të bëhen anëtarë të saj sa më shpejt. Gëzuar Evropë e dashur!

Jam i zhgënjyer sepse me asnjë fjalë keqardhjeje nuk shkruan për rrënimet barbare të tri qytetërimeve të lashta në ato vende të Lindjes së Mesme e të Afërme që po ndodhin edhe nën patronatin politik e ushtarak të disa

## HOROSKOPI

### DASHI

Të lindurit e kësaj shenje do të ner-vozohen sot. Përpiguni të mbanin veten nën kontroll dhe të zbatoni me qetësi planin tuaj. Ka gjasa që dikush t'ju kërkojë ndihmë. Do të kaloni një mbrëmje romantike dhe të ngrohtë.

### DEMI

Duhet të shmangni me doemos agresivitetin. Kjo këshillë vlen mbi të gjitha nëse do të zhvilloni një bisedë të rëndësishme në punë, por edhe nëse bisedoni më fëmijët. Ndër të tjera, e enjta do t'ju sjellë rezultate produktive.

### BINJAKET

Disa Binjakë do ta kalojnë ditën në kushte jo të rehatshme. Dikë nuk do t'ju funksionojë ashtu siç duhet. Megjithatë gjërat do të zgjidhen në mbrëmje. Do të gjeni pak kohë për t'ju përkushtuar vetes.

### GAFORJA

Gaforet nuk duhet të shtyjnë një bisedë të rëndësishme sot. Ajo premtim të jetë shumë produktive nën disa kushte të caktuara. Besoni në vetvetë, mos ekzagjeroni. Ndër- sa sa i përket sektorit financiar, tregoni durim. Në fund të ditës dikush do të ketë nevojë për mbështetjen tuaj.

### LUANI

Dita e sotme premtim të jetë shumë produktive për Luanët. Do të kenë sukses në karrierë, por mund të realizoni edhe një udhëtim të shkurtër. Privatësia kërkon vëmendje të veçantë. Disa Luanë familjarë mund të lundohen, për shembull për të filluar me dikë pas shpirtit së partnerit/partneres.

### VIRGJERESHA

Besimi në vetvetë do t'ju ndriçojë ditën. Do të përballeni me një situatë të vështirë, pasi dikush do t'ju tregojë forcën. Do të keni sukses në aspektin financiar dhe personal. Nuk rekomandohet të ndani mendimet tuaja me dikë që nuk i besoni shumë.

### PESHORJA

Përgjithësisht të lindurit e kësaj shenje do të jenë të lumtur sot. Disa do të shënojnë sukses në karrierë. Ndërsa disa të tjerë do të kenë vëmendjen e seksit të kundërt. Do të gjeni kohë mjaftueshëm për t'ju përkushtuar vetes, sidomos kujdesit ndaj shëndetit.

### AKREPI

Akreptë rekomandohen të qëndrojnë larg debateve. Shmangni çdo konflikt pasi mund të bëheni pjesë e një mos-marrëveshjeje. Karriera ose financat do të kërkojnë më shumë përpjekje. Është dita e duhur për të nisur zbatimin e ideve të reja.

### SHIGJETARI

Shigjetarët duhet të mendojnë fillimisht për veten dhe më pas për çështje të tjera. Duhet të jeni më të vëmendshëm ndaj partneres/partnerit tuaj. Shigjetarët familjarë do të shkaktojnë xhelozitë tek bashkëshorti/bashkëshortja.

### BRICJAPI

Disa Bricjapë do të kenë nevojë vetëm për relaks. Përpiguni të shmangni çdo bisedë që mund t'ju shkaktojë irritim. Shëtnisi, bisedoni me mikun tuaj të ngushtë ose mund të shkoni tek një psikolog për t'u ndjerë sa më mirë.

### UJORI

Ujorët do të ndihen shumë të kënaqur me veten. Do të keni sukses në marrëdhëni personale, por edhe në çështjet financiare. Në lidhjen tuaj romantike do të keni disa ndërhyrje të vogla. Mos nisni të "luftoni" pa një plan strik.

### PESHQIT

Këtë të Enjte do ta mbani mend si një ditë shumë të bukur. Rrethananat do t'ju ndihmojnë si në çështjet personale ashtu edhe profesionale. Megjithatë mos harroni të mbari veten nën kontroll. Mos u afroni me njerëzit që kanë një të kaluar të errët apo me reputacion të paverifikuar.

**KORÇARËT ZGJOHEN NË MERKATO**



**Sibo e Pervan, Skënderbeu njofton zyrtarizimin e dyfishtë**

Nuk humbet kohë Skënderbeu. Menjëherë pasi ka liruuar vendet e lojtarëve të huaj në ekip, ka zyrtarizuar dy afrime të tjera. Bëhet fjalë për ganezin Kuasi Sibo dhe Marko Pervan. Kuasi Sibo është një mesfushor nga

në Armeni. Pas një sezoni atje, tashmë prej verës së 2018-ës, ai është pjesë e Uotfordit, ku aktivizohet për ekipin U-23. Nga ana tjetër, Marko Pervan është një mesfushor, me tipare sulmuese. Kroati 22-vjeçar, ka qenë pjesë e disa skuadrave në vendlindje, si RNK Split, Cibalia, apo Sibenik, ndërsa prej 2018-ës, luan për NK Osijek.

**KUPA E ITALISË**



**Epabesueshme, Fiorentina mund Romën 7-1**

Një rezultat i një tjetër epoke, shifra të pabesueshme. Aq më tepër kur luajnë mes tyre Fiorentina dhe Roma. Të humbasësh 7-1 në futbollin modern ngjan e habitshme, kur ky rezultat vjen mes dy ekipeve pa shumë diferenca mes tyre, atëherë habia dhjetëfishohet. Në "Artemio Franki" të Firences, Fiorentina vendëse ka shpartalluar Romën me rezultatin 7-1, duke kaluar në gjysmëfinalen e Kupës së Italisë. Heroi i takimit është Federico Kieza, autor i tre golave në minutat 7, 18 dhe 74. Dy gola për formacionin vjollcë i shënoi Xhovani Simone në minutën e 79-të dhe 89-të, ndërsa Muriel dhe Benasi plotësuan goleadën e rëndë në portën e Olsentit. Për Romën, golin e ndërroi Kolarov, që shkurtroi për kohësisht diferencat në 2-1 në minutën e 28-të.



Jeton Selimi

Gega merr mbrojtësin e shumëkërkuar. Mensah, i pakënaqur me aktivizimin e pakët, zgjedh bardheblutë

**Idrizi vishet i kuq, Mensah drejt Tiranës**

*Zien kryeqyteti, afrime për dy ekipet e Superligës*

Skënder Gega ishte në skërkim të një mbrojtësi të djathtë si alternativë e Labinot Ibrahimit dhe kishte kërkuar me ngulm që në verë anësorin vlonjat Hektor Idrizaj, por dëshira atëherë nuk iu plotësua. Gjithsesi, Gega mund të kënaqet tani, pasi Idrizaj është zyrtarisht një lojtar i Partizanit. Mbrojtësi titullar i Kamzës do të kalojë te klubi kryeqytetas pas shumë ditësh tratativash me presidentin Naim Qarri, që nuk pranonnte kurrsesi ta linte të lirë lojtarin e tij. Gjithsesi, klubet kanë gjetur gjuhën e përbashkët dhe më në fund Idrizaj ka veshur fanellën e kuqe. Partizani zyrtarizoi afrimin e ri në faqen e tij, ku njoftonte: "Klubi njofton arrijtjen e marrëveshjes me Hektor Idrizajn. Mbrojtësi vlonjat, i cili do të mbajë fanellën me numër 4, do t'i bashkohet menjëherë ekipit. Në Kategorinë Superiore përveç Kamzës, Idrizaj ka qenë pjesë



edhe e Flamurtarit, Skënderbeut, Bylisit dhe Teutës.

Mirëse vjen NëFamiljen E Kuge Hektor". **MENSAH TË TIRANA** Te Tirana po fryn erë e

mbarë! Pas shumë e shumë zhgënjimeve, bardheblutë duket se kanë gjetur ritmin e duhur dhe pas fitores bindëse me Kamzën, është thyer dhe akulli me tifozët. Natyrisht duhet shumë më

shumë se kaq, por bazat janë hedhur. Parë këtë situatë, drejtuesit bardheblu po bëjnë çmos që në orët e fundit të merkatos t'u dhurojnë atyre një goditje të denjë. Kështu, presidenti Hailli po

bën çmos që të veshë bardheblu një nga mesfushorët e rivalëve të kryeqytetit. Bëhet fjalë për Emanuel Mensah, ganezin e Partizanit, që në pjesën e parë të sezonit nuk është preferuar si titullar nga trajneri Skënder Gega. Mensah, aftësitë e të cilit janë të padiskutueshme, është i pakënaqur me faktin se shikohet si lojtar stoli nga Gega dhe duket se ka vendosur që të pranohet ofertën e Tiranës. Duket se Partizani nuk ka ndërmend të bëhet pengesë në këtë mes, ndonëse Mensah është nën kontratë me të kuqtë. Lojtari vuan mungesën e hapësirës, ndërsa edhe trajneri Skënder Gega duket se nuk ka ndërmend që të bëhet pengesë, pasi me ardhjen e Dilaver Dukës, hierarkia në ekip ka ndryshuar. Emanuel Mensah pritet të prezantohet te Tirana ditën e sotme.

**ALTERNATIVA**

**Bie pista e kroatit Perisiç, Arsenali shënjestron Karraskon**


Interi nuk e lëshon kroatin Ivan Perisiç, ndonëse ky i fundit pati bërë një kërkesë zyrtare në klub që ta lejonte të transferohej jashtë. Këtë e konfirmoi vetë drejtori zikaltër, Bepe Marota, që i mbylli në këtë mënyrë derën Arsenalit për nënshkrimin me nënkampionin e botës. Në këto kushte, klubi londinez ka vendosur të ndryshojë objektin. Bëhet fjalë për Janik Karrasko, që aktualisht aktivizohet në kampionatin kinez me Dailan Jifangun. Karrasko nënshkroi me Dailan Jifangun në vitin 2016, duke kaluar në kampionatin kinez nga Atletiko e Madridit, ndërsa tashmë ka shprehur dëshirën për t'u rikthyer në Europë.



**QESH ME DJALIN E ZIDAN**

**Isko, aspak i shqetësuar me qëndrimin në stol**

Që nga largimi i Zidan si trajner i Real Madridit, 'Los Blancos' po kalojnë momente jo shumë të mira në kampionat, pasi nuk shihen më pretendentë për titullin kampion. Me ardhjen e Solarit në krye të stolit, shumë futbollistë po shprehin pakënaqësi dhe një ndër ta është ylli spanjoll, Isko. Ai nuk po arrin të gjejë minuta me Solarin dhe shumicën e ndeshjeve i nis nga stoli dhe paraqitet në fushë janë shumë larg pritshmëri. Megjithatë, Isko duket se nuk po e vuan shumë këtë zgjedhje që ka bërë trajneri i tij dhe ka kohë për të bërë edhe shaka në pankinë. Kamerat e kanë fokusuar në një moment futbollistit spanjoll teksa fliste me djalin e Zinedin Zidanit, Luka Zidan. Ai i thotë në një moment që e di mirë arsyen se pse nuk luan. "Luka, nuk luaj sepse unë jam i dobët" i thotë Isko, ndërkohë që futbollistët e tjerë nisin të qeshin.



**Valdet Rama pranë firmës**


**"Çmendet" Gjici, gati t'i japë Cungut lojtarin e Kombëtares**

Dy pikët e humbura ndaj Laçit e thelluan diferencën mes Kukësit dhe Partizanit kryesues në 5 pikë. Tashmë që gjysma e kampionatit ka kaluar, beteja për titull sa vjen e ashpërsohet. Veç kryeqytetasve dhe verilindorëve, në garë për titull janë edhe durraskët e Teutës, ndaj presidenti i Kukësit ka vendosur të marrë masat e duhura. Safet Gjici ka ndërmend t'i dhurojë trajnerit të tij, Armando Cungut, një as të vërtetë për mesfushorin. Bëhet fjalë për ish-lojtarin kuqezi, Valdet Ramën, i cili vitin e shkuar është aktivizuar për kinezët e Jianbian Funde, por prej thuasje një viti është pa ekip. Në periudhën e tij me fanellën kuqezi, Valdet Rama është aktivizuar në 15 takime dhe ka shënuar tre gola, ndërsa nga tifozët mbahet mend për shpërthimet e tij sulmuese, që sillnin panik në mbrojtjet kundërshtarë.





**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. E famshja Curie
5. Më e mira është rekord.
9. Inicialet e Kurosawa-s.
11. Eshhtë edhe ai i mendimeve.
12. Një mund të jetë zemëruak
13. Eshhtë dollapi.
14. Gjysmë mimize.
15. Fillojnë sefte.
16. Ishte shkollë e Aristotelit.
20. Ndodh në kufij.
22. Bëhen me ambalazh.
23. Janë idhnakë.
25. Fillojnë titujt.
26. Do të bëhen pemë.
27. Ashtu si jeton heremiti.
29. Eshhtë dhomë e lartë.
30. Janë spanjollët dhe portugezët.
32. Ishte filozofi që preu damarët.

34. Janë gjuhë...veshi.
35. Musketierët e Dumas.
36. Lila këngëtare.
37. Kufizojnë takimet.
38. Ullmann aktore.
39. Mbledh baskët separatistë.
40. Fillojnë kapjen.
41. Inicialet e Delon.
43. Lumi i Bernës.
44. Eshhtë numri të parit.
45. Një thirrje me emra.

**VERTIKAL**

1. Farrow aktore.
2. Me Romeo në makinë.
3. Rolet pa zë.
4. Kufij itinerari.
5. Ai ekzekutiv u bë bashki.
6. Në mes të dhomës.
7. Një tabu islamike
8. Mbyllin fushatat.
10. Janë festime
11. Lehar kompozitor.
12. Janë shtyllat për vela
14. Ata të Ferrari-t qëndrojnë në box.
16. Duhet fituar me djersë.
17. Piktura pa kura.
18. Janë dokumente partie.
19. Në fund të vitit.
21. Farkëtoi armët e Akilit.
22. Një është për kërcim.
24. Athinaja e romakëve.
25. Janë kapriçiot.
27. Një tis mjegulle.
28. Kërcimi i Fred Astaire.
31. Edwards regjisor.
33. Parker regjisor.
38. Luan në kufij
39. Inicialet e Rohmer.
42. Fillojnë detyrën.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Lama i Tiletit.
5. Janë vendet e lira
11. Martin i Jack London.
13. Comaneci e famshme e gjimnastikës.
15. Ekstrema në sirtar.
16. Janë princë arabë.
17. Një treshe në skenë.
19. Një provë inteligjence.
21. Gjysmë tatimi.
23. Gjysmë eolike.
24. Ekstrema në studim.
25. Bëjnë stil të lirë
28. Ndal në kufij
29. Kaluar në krye.
30. Një tragjedi... e Dreiser.
33. Grier aktore.
34. Dashi kur mungon ai
36. Eshhtë zanore në filma
38. Kufizohet në kufij
39. Entë Civile Europiane.

**VERTIKAL**


40. Janë galeri në rrugë.
41. Ramazzotti këngëtar
42. Mbyllin një tender.
43. Agjenci Formacioni Tiranë.
44. Eshhtë pjesë e borxhit që paguhet.
46. Gjysmë kandil
48. Jessica Parker aktore.
49. Inicialet e Presley.
50. Nuk shuhej dot nga Tantal.
51. Janë thënie të njerëzve të famshëm.
52. Qendër fitimi
1. Eshhtë halli.
2. Fillon me rruga...
3. Kastile janë në fund
4. Janë në skajë.
6. Eshhtë vendi aderues
7. Ka kryeqytet Doha.
8. Inicialet e Daudet.
9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
10. Iglit le Lazio.
12. Janë zjarrvënës.
14. Flanders e Defoe.
18. Shkroi Rinoceronti.
20. Ekstrema në slam.
22. Janë trille.
25. Qytet italian.
26. Jepen për hartim.
27. Fillojë takimet.
29. Kufizojnë kënde.
31. Janë vendet e para.
32. Një greminë.
35. Eshhtë logarin që qërohet.
36. Ndëron me ilaçe.
37. Massari aktore italiane.
38. Eshhtë melodramë.
40. Një thirrje e dëshiruar nga maja e direktor.
41. Kush ka... fërgëllon.
44. Një i fundit mbi të gjithë.
45. Një pjesë e satelitetëve.
47. Në krye të njerëzve.
48. Sikur janë në krye.
49. Inicialet e Taylor që që aktore..



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 |   |   |   | 2 | 6 | 8 |   |   |
|   |   |   |   |   | 8 |   | 1 |   |
|   | 2 | 4 |   |   |   |   | 9 | 3 |
| 7 |   |   | 4 | 5 | 6 |   |   |   |
|   |   | 1 |   | 8 | 7 |   |   |   |
| 2 |   |   |   | 1 |   |   |   |   |
|   |   |   | 6 |   |   | 1 |   |   |
|   | 9 |   |   |   |   |   |   | 6 |
|   | 5 |   |   |   | 3 |   |   | 9 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 5 | 9 | 8 | 3 | 2 | 6 | 7 | 1 |
| 2 | 3 | 1 | 9 | 6 | 7 | 8 | 4 | 5 |
| 6 | 7 | 8 | 4 | 5 | 1 | 9 | 2 | 3 |
| 5 | 1 | 3 | 6 | 2 | 9 | 7 | 8 | 4 |
| 7 | 4 | 2 | 5 | 1 | 8 | 3 | 9 | 6 |
| 8 | 9 | 6 | 3 | 7 | 4 | 1 | 5 | 2 |
| 9 | 6 | 5 | 7 | 4 | 3 | 2 | 1 | 8 |
| 1 | 8 | 4 | 2 | 9 | 6 | 5 | 3 | 7 |
| 3 | 2 | 7 | 1 | 8 | 5 | 4 | 6 | 9 |

*Argëtim filozofik*

- Taksat e mira nuk ekzistojnë.  
 -Ne debatojmë për faktin se një komb që përpiqet ta taksojë veten drejt prosperitetit është si një njeri që qëndron i ulur mbi një kovë dhe përpiqet të ngrihet nga doreza e saj.  
 -Demokracia është forma më e keqe e qeverisjes, pas gjithë të tjerave.  
 -Disa e shohin sipërmarrjet private si shënjestra grabitqare që duhet goditur, të tjetër e shohin si një lopë që duhet mjetë, por pak janë ata që e shohin si një kalë i fuqishëm që tërheq karron.  
 -Vesi i pandarë i kapitalizmi është ndarja e pabarabartë e bekimeve; virtuti i pandashëm i

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

|    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4  | 6  | 8  | 3  | 6  | 10 | 10 | 4  | 16 | 3  | 2  | V | A | P | E | N | I | V | O | D | K | A |   |
| 10 | 3  | 9  | 5  | 7  | 4  | 8  |    | 6  | 12 | 4  | A | R | A | H | E | L | M | I | M | I | D |   |
| 4  | 4  |    | 19 | 4  | 11 | 1  | 2  | 3  | 18 | 5  | T | I | P | E | R | I | O | D | I | K | A |   |
| 18 |    | 11 | 5  | 6  | 5  | 13 | 5  | 9  | 4  | 7  | E | M | O | D | E | R | N | E | T | T | P |   |
| 5  | 12 | 3  | 2  | 5  | 6  | 3  | 2  |    | 9  | 5  | R | E | I | D | I | I | O | A | O | T |   |   |
|    |    | 6  | 4  | 2  | 4  |    | 17 | 4  | 1  | 5  | P | P | A | R | A | D | A | A | T | R |   |   |
| 5  | 2  | 3  |    | 3  | 7  |    | 2  | 5  |    | 4  | P | E | A | K | I | L | O | N | I |   |   |   |
| 13 | 3  | 12 | 3  | 2  | 3  |    | 4  | 2  | 5  | 13 | R | A | S | T | E | D | E | N | I | R | O |   |
| 2  | 13 | 16 |    |    | 2  | 3  | E  |    | 5  | 12 | O | L | E | L | E | S | T | E | T | T |   |   |
| 17 | 12 | 4  | 1  | 12 |    |    | M  | 6  |    | 2  | V | H | I | E | N | A | E | N | T | O |   |   |
| 5  | 4  |    | 7  | 4  | 8  | 4  | I  | 1  | 12 | 5  | A | R | I | A | N | E | T | R | R | A | P |   |
| 9  | 13 | 8  |    |    | 2  | 17 | R  | 4  | 8  | 2  | T | E | R | R | I | T | O | R | D | E | T | I |

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | V | A | B | E | A | A | L | M | A |   |   |   |
| F | U | A | M | A | R | E | T | A | T | A | R |   |
| E | S | F | E | R | A | T | N | O | R | A |   |   |
| L | A | T | L | I | P | O | T | I | M | I | A |   |
| M | O | N | O | T | O | N | E | T | R | I | T |   |
| S | A | L | D | O | R | A | O | N | E |   |   |   |
| E | T | I | I | N | T | E | R | U | N | I |   |   |
| N | O | T | I | E | L | I | N | R | I | I |   |   |
| D | R | E | R | E | E | T | N | I | K | P |   |   |
| E | A | S | I | A | O | M | E | R | A |   |   |   |
| S | T | I | N | A | K | U | R | R | E | A | R |   |
| P | M | I | T | E | T | E | S | T | E | T | I |   |
| M | A | T | I | S | S | E | K | A | L | A | T | E |
| I | R | O | N | H | B | I | D | O | N | E | T |   |
| S | A | O | P | E | R | A | A | L | E | T | I |   |
| S | T | E | A | N | A | T | E | M | A | T | E |   |
| K | P | E | L | I | K | A | N | I | A | T | A |   |
| E | P | I | D | E | M | I | K | E | R | E | S |   |
| D | G | R | O | T | E | A | A | L | B | E | R | T |
| I | L | M | T | M | I | E | T | A |   |   |   |   |
| N | A | S | S | P | A | K | O | T | S | R |   |   |
| A | K | T | U | A | L | I | T | E | T | I |   |   |
| T | E | A | M | E | E | R | T | M | E | R |   |   |
| T | R | A | G | E | T | I | A | I | D | A | N |   |

*Thënie të mençura*

- socializmi është ndarja e barabartë e varfërisë.
- -Një komb që i vë taksa vetes për prosperitetin është si një njeri brenda në kovë, që përpiqet ta ngrejë veten nga doreza.
- -Një paqësor është dikush që ushqen një krokodil, me shpresën se do të jetë i fundit që do të hahet.
- -Problemet e fitores janë më të pëlqyeshme se
- problemet e mundjes, por nuk janë më të lehta.
- -"Që tani e tutje, nuk do ta përfundoj kurrë fjalinë me një parafjalë.
- -Një fanatik është dikush që s'mund ta ndryshojë mendjen dhe nuk do të ndërrojë as temë.

